

**STAVRI PONE**

**MIRËMËNGJES, E DASHUR**

**Roman**

Tiranë, 2006

Redaktor: **Granik DANI**

Kopertina: **Artur SPAHO**

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

ISBN xxxxxx

*Çdo ngjashmëri me ngjarje e persona realë është krejt e rastit.*

***Autori***

I Xhejit dhe Dorianit



Artisti i lirë është i vetmi disident i përjetshëm i  
çdo pushteti despotik.

## 1

Një dritësim i shkëlqimtë, si i situar nga një mjegullimë e artë, depërtoi nga dritarja dhe Loredana hapi sytë. Kur pa murin e dhomës të veshur me një drapë të gjelbëreme dhe dritaren e gjerë me grila vertikale ngjyrë qumështi u kujtua se ndodhej në Salerno.

Ishte mëngjes herët fillimigushti dhe në dhomë mbisundonte qetësia e zakonshme e hoteleve, e prishur paksa nga zhaurima e mbytur e karrocave të shërbimit që vinte nga mesorja, por edhe përmes saj dëgjohej oshëtima e lehtë e dallgëve.

Ajo u ngrit dhe hapi grilat. Sytë iu ledhatuan nga kaltërsia e detit dhe nga dantella e shkumëresë së bardhë të bregut përtej rripit të rërës, të mbushur me shezlongë të mbledhur stivë e me çadra të ulura, që kufizohej në njërën anë nga deti dhe në tjetrën nga një gjelbërim i harlisur me pisha, palma, voshtra, gjeorgjina e landra që rrethonin vilat në afërsi të plazhit.

Hyri në banjë e bëri dush e teksa thante flokët përpara pasqyrës mbeti për një hop e palëvizur: iu duk se anash syve i qenë formuar ca rrudhëza. Iu afrua pasqyrës, u pa me vëmendje dhe u lehtësua. Rrudhat formohen pas moshës dyzetvjeçare, tha me vete, kurse unë jam njëzet e tetë. Jam akoma e re? Sigurisht, vijoi dialogun teksa bënte një tualet të lehtë.

Hapi gardërobën dhe u mendua pak. Zgjodhi një bluzë batisti të bardhë me vija horizontale të kaltra dhe një palë xhinse të shkurtra të dalëfijesh përfundi, mori çantën, kyçi derën, zbriti në holl, ku la çelësin, dhe shkoi në restorant. U ul në një tryezë që binte nga perëndimi, prej nga mund t'ia hidhte sytë peizazhit bregdetar që nuk ngepej së pari.

Hodhi qumësht e kafe në filxhan, leu një fetë bukë të thekur me gjalpë e reçel mjedre dhe ndërkohë pa një dorë që valëvitej në formë përshëndetjeje. Ishte regjisori Xheki Kejxh, i ulur me asistentin e vet, një djalosh thatim me emrin Mario. Xheki mbante në kokë një panama të bardhë që kontrastonte dukshëm me flokët dhe mjekrën e tij të zezë. Ajo ia ktheu përshëndetjen po me dorë.

Me Marion që njohur një ditë më parë, kurse me Xhekin prej tre vjetësh, kur si ai, edhe ajo, vinin për herë të parë në festival. Megjithëse ajo e fliste mirë anglishten, Xheki nuk i fliste kurrë anglisht, por me një italishte gjysmake. Në dy vitet e para Xheki kishte qenë kandidat për çmim, por s'e kishte marrë. Ndoshta e merr këtë vit, mendonte ajo,

se filmin e ka shumë të mirë.

- Ç'kemi, bukuroshe? - i tha Xheki me t'u ulur.

- Mirë. Ju si ia kaluat?

- Si në vetmi. Më saktë, në shoqërinë e ëndrrave. Megjithatë, edhe me to ndihesh i vetmuar.

- Oh! Po ju njihni plot njerëz këtu.

Xheki ndezi një puro. Ajo i hodhi Marios një shikim shkarazi dhe nga sytë e tij të skuqur hamendësoi se natën ai do ta kishte kaluar në disko e do të kishte fjetur vetëm afër mëngjesit.

- E di si është puna, e dashur? Kur nuk të shoqërojnë njerëzit me të cilët do të shoqërohesh, ndihesh i vetmuar.

Ajo vuri buzën në gaz. Një vit si sot Xheki e ndiqte në çdo hap, në çdo seancë filmi e në çdo takim me personalitete të kinemasë, kishin shkuar edhe në disko, ku ai i kishte thënë se e donte si i çmendur, por ajo nuk i qe përgjigjur. Edhe pas festivalit i kishte vazhduar orvatjet dhe gjatë vitit të kaluar kishte shkuar në Napoli tri herë vetëm për të, qenë takuar e kishin shkuar në lokale, por gjithçka kishte mbetur me aq. Ajo admironte forcën e tij prej bualli, spontaneitetin dhe çiltërsinë e tij, por në kontrollet e imëta që u bënte ndjenjave të saj nuk gjente gjë tjetër në to veç një lloj tërheqjeje seksuale ndaj tij. Në prag të puthjes, në takimin e tyre të fundit në Napoli, ajo i qe shmangur... Ai kishte mbetur i zhgënjyer, por nuk i kishte humbur shpresat.

- Si t'u duk filmi im?

Ajo u shkund nga përsiatjet, ngriti kokën, e pa në sy dhe iu përgjigj:

- Shumë i mirë. Më i mirë se ai i vitit të kaluar.

- Me gjithë mend?

- Po.

- Do të shkruash dy fjalë për të?

- Patjetër, - i tha ajo dhe buzëqeshi.

- Rrofsh, bukuroshe.

Tingulli i zërit të tij qe i çiltër, me natyrshmërinë e një fëmije. Ai hoqi panamanë dhe e la mbi karrige. Ishte rreth 37 vjeç, i pashëm e shpatullgjerë. Teksa i hodhi shkarazi një vështrim, asaj iu bë se një tel të brendshëm iu nxeh gjer në inkandeshencë dhe një korrent i flakëriu në mediumin erotik. Klitori iu tendos si të ishte në pritje për atë ledhën idiosinkratike që dinte t'ia bënte vetëm Pamela dhe u ndje e pushtuar nga një dëshirë e vagullt për diçka të tillë nga ai burrë, i cili, të paktën deri vjet, ishte beqar.

Xhekuit iu bë qejfi për vlerësimin e filmit. Edhe Marioja, një djalosh

me prejardhje italiane, vuri buzën në gaz. Xheki kishte marrë dy-tri trofe në vende të tjera, por ky festival ishte më i shquari dhe Çmimi i Madh në të e vendoste regjisorin në panteonin e këtij zhanri.

Ajo e hoqi shikimin nga Xheki e u bë gati të ngrihej.

- Do t'i shohësh të gjithë filmat e paradites?

- Sigurisht. - Ajo vuri buzën në gaz. - Për këtë jam këtu.

Ajo e pa qartë irnosjen në sytë e tij. I erdhi keq, por kishte vendosur që ditët e para të mbante largesën e vitit të kaluar, kurse më pas me të parë e me të bërë. E kuptoi pikëllimin e tij nga shuarja e shpresës se ndoshta ajo do t'i propozonte të shkonin në ndonjë lokal së bashku për një ose dy orë. Humbëtira e prerive u shfaq në sytë e tij si në dy miniekrane dhe ai u kthye në një shkretan i braktisur. Prerihumbëtar i pashpresë, mendoi ajo. Marioja e ndiqte me njëfarë mimike mëshiruese terratisjen e mjeshtrit të tij.

Ajo mori çantën, i përshëndeti dhe nisi të përshkonte sallën me çap të shpejtë. Xheki e përpinte me sy atë ecje delikatësisht femërore të trupit të saj të hatashëm me atë bel të hollë e me ato linja tmerrësisht ngashënjyese të ijeve dhe të këmbëve të saj të gjata.

Teksa hapte derën e Citroenit të saj të kuq të markës së fundit ajo ende mendonte për Xhekin, për shpresën vezullcake në sytë e tij dhe për atë brerore pezmi që rrethonte figurën e tij sa herë që ajo i shmangej, çka e kthente atë burrë në një fëmijë lutës dhe për herë të parë mendoi se ndoshta në një nga ditët e ardhshme do t'i jepej.

Ndezi makinën dhe e nisi. Në atë orë në Salerno nuk kishte trafik dhe shpejt doli në rrugën e *Valle Pianës*. Papritur timoni iu drodh në duar dhe makina desh përfundoi në kanal. Në mendje iu përhi - pse pikërisht tani, nuk mund ta shpjegonte dot - ai aktori që luante rolin e mësuesit në filmin shqiptar që do të konkurronte në seksionin *Free to Fly* (12-14 vjeç). Iu kujtua sidomos çasti kur sytë e saj e kishin ndeshur në ekran dhe ajo kishte mbetur fytyrështangur. Filmi i kishte bërë përshtypje për lojën e bukur të fëmijëve dhe të mësuesit, por nuk kishte qenë loja e aktorit që luante mësuesin ajo që e kishte shkundulluar aq sa nuk kishte qenë në gjendje të mbante shënime në bllok. Kishte qenë diçka tjetër, diçka tmerrësisht tjetër. Diçka si gërvishtja e një plage. Ajo e përdorte stenografinë me sy mbyllur, por dora i kishte ngecur. Kishte vendosur ta shihte prapë atë film dhe e kishte parë. Ishte viti i tretë që drejtuesit e festivalit e thërrisnin në *Valle Piana* tri javë përpara fillimit të festivalit në bordin e përzgjedhjes së filmave.



Në shikimin e dytë që trazuar më shumë. Titrat i pa me vëmendje e megjithatë emrin prapë s'ia kishte mësuar, por s'prishte punë, e gjente në katalogun e festivalit. Dhe e kishte gjetur. Po ç'rëndësi kishte emri? Rëndësi kishte diçka tjetër përtej emrit, që edhe tani vazhdonte ta trazonte. Gjëja më e mirë ishte të mos e shihte më atë film, të mos shkonte në shfaqjen e konkurrimit. Të paktën ashtu do të ndihej më e qetë. Mirëpo ai ishte edhe shansi i fundit për ta parë edhe një herë.

Timonin e lëvizte mekanisht dhe makina sikur e ndiqte vetë rrugën që gjarpëronte përpjetë kodrave të mbushura me bashtina, korije e prozhme. Në ultësirë dukeshin pemë, lëndina e vila të bardha me çati të kuqe, kurse në pjerrina harlisej gjelbërimi i ullinjve e i vreshtave. Ishte fillim gushti, vapa nisi të ndihej edhe në atë lartësi dhe ajo hapi kondicionerin.

Në tri festivalet e kaluara kishte parë aq e aq filma, me aq e aq aktorë - shumë syresh të pashëm - por vetëm tek ai kishte vënë re diçka që e kishte bërë t'i duheshin minuta të tëra për të përballuar pamjen në ekran. Dhe kishte qenë pas gjysmës së filmit që ajo që ndërgegjësuar për burimin e asaj dalldie që i kishte shpërthyer brenda vetes duke ia thyer pasqyrën e kujtimeve në mijëra grimca, për t'i mbledhur me mund së bashku dhe për të formuar të tërën e tyre në një kohë të largët. Ai aktor ia kishte plagosur kujtesën duke e kthyer 11 vjet pas. Atëherë, pikërisht në fillim gushti, si sot, ajo ndodhej në vilën e familjes së saj në Agropoli. Kur kishte parë atë aktor në ekran, ai qytet i dashur që nga fëmënia që zvogëluar e i qe mbledhur në zemër si një plagomë e përgjakur duke ia humbur lirshmërinë e shendin dhe ajo kishte thënë me vete se ta kishte ditur kështu nuk do të kishte pranuar që këtë vit të bënte pjesë në bordin përzgjedhës.

## 2

Si të qenë përngjeshur në formë lazeri rrezet e ekranit kishin formuar një thikë që ia kishte malcuar atë plagë të vjetër duke bërë që gjaku i kujtimeve t'i rridhte venave të dhimbjes. Atëherë banonin në Napoli (më pas u shpërngulën në Romë) dhe i ati, avokat, i lauruar në Oksford, shkonte çdo verë në Agropoli me gruan dhe dy fëmijët, Benedeton dhe Loredanën. Atë verë ajo ishte 17 vjeçe dhe kishte mbaruar vitin e parafundit të liceut. I zoti i vilës fqinjë kishte mikpritur një familje nga Piemonti ku bënte pjesë edhe një djalë me emrin Luixhi.

Ishte 19 vjeç, i hajthëm, i giatë, me flokë të drejtë ngjyrë kashte dhe me sy gjelbëroshtë të pikëluar me grimca si të gentianës.

Ajo nuk e harronte kurrë çastin kur kishte ndeshur për herëtë parë vështrimin e tij: qe drithëruar nga një shkundullimë që i kishte vrujuar nga gjinjtë duke iu ngjitur deri në rrëzë të flokëve. Rrinte shtrirë mbi peshqirin e shtruar në rrëzë pranë shezlongëve bosh. Prindërit kishin shkuar te klubi, kurse Beni për të peshkuar përtej shpellave të *Fortino Grotte-s*. Ajo lexonte romanin *Emri i Trëndafilut* të Ekos duke pritur që deti të ngrohej.

Së pari kishte parë një hije dhe kishte ndier fëshfërimë hapash, por nuk u kishte kushtuar rëndësi. Kur kishte ndier praninë e dikujt kishte hequr shikimin nga libri dhe e kishte parë. Ai qëndronte në këmbë i vizatuar në sfondin e detit; ajo shihte një copë nga syprina e blujtë përmes këmbëve të tij. Kur sytë u qenë mbërthyer kryqazi ajo qe tmerruar. Për t'u çuditur, se vështrimi i tij kishte qenë tejet miqësor.

Lahemi? Ajo kishte lënë librin, ishte ngritur në pozicionin ulur dhe nuk ia ndante sytë. Kishte diçka misteriozisht tërheqëse tek ai djalë, por një gjyç ters ia kishte bllokuar kraharonin për t'i thënë po. Nëse ju shqetësova, më falni. Dhe u bë gati për t'ia mbathur. Ajo qe ngritur në këmbë, kishte shkundur pak rrëzë nga bikinit dhe vështrimet e tyre qenë kryqëzuar sërish. Në thellësi të qenies i qe ndezur një shkëndijë mizore. Nuk kishte folur, por qe drejtuar nga deti e ndjekur prej tij.

Kishin qëndruar cazë buzë ujit dhe ai i kishte thënë emrin dhe nga vinin, se ishte student për arkitekturë në Torino dhe se aty vinte për herë të parë. Jugu e kishte tërhequr gjithnjë, por familja e tij shkonte në Portofino. Keni qenë ndonjëherë në Portofino? Është një qytetth i bukur në Gjirin e Ligurias. Ajo qe gëlltitur e mezi kishte nxjerrë një *jo*. Po dhe Agropoli juaj qenka një mrekulli. Këtu vini çdo verë? Ajo pohoi me një tundje të lehtë të kokës. Vetëm pyetjes se si quhej i qe përgjigjur me një zë më të tingullt, Loredana. Por më thërrasin Lori. Dhe qenë futur në det.

Kurrë nuk qe gjallëruar fantazia e saj sa ato dhjetë ditë të shoqërimit me të. Në shkollë kishte djem të bukur, shumë i vinin rrotull, me shumë syresh shoqërohej, por nuk dashuronte asnjërin. Në jetën e saj mbretëronte mosdashuria. Dashuria ishte diçka që ajo as e kuptonte as e ndiente. Gjithë ç'kuptonte ishte se ky i panjohur i kishte ngjallur ca ndjesi të paçanësuar që ajo nuk e kishte ditur se ekzistonin brenda saj. Misteri qe shfaqur në dritë të diellit, në breg të detit, në

formën e një djali të hajthëm me sy bleroshë e me një vështrim çuditërisht ndjellës.

Kishte shumë kujtime nga ato ditë. Po ai pse s'kishte qëndruar një muaj, siç kishte thënë? Nuk e dinte. Nuk do ta dinte kurrë. Dinte se tashmë përmasat dhe rendi i gjërave kishin ndryshuar, se ajo dilte në plazh si e tërhequr nga një forcë intimisht e ëmbël, se deti ishte më i bukur (si s'e kishte vënë re më parë?), se gjithçka që bërë më llamburitëse e më e tingullt a thua se ajri që kthyer në kristal ku përthyeshin grimca drite dhe tingujt merrnin vibrime muzikore dhe ajri dhe era dhe dallgët pëshpërisnin vetëm emrin e tij.

Ditët fluturonin duke lënë pas pupla të ngjyrshme kujtimesh që bëheshin tufë në shpirtin e saj. Ajo ndihej si një pupël në praninë e tij dhe dëshironte që ai ta merrte në duar e të luante me të. Sa e dëshironte prekjen e tij! Të shtriheshin në gëmushë në vetmi në mes të veronikave dhe të kapërtheheshin dhe ai ta puthte dhe t'ia hiqte bikinit dhe ta shtrëngonte fort. Kishte një mpiksje të ndezur ndjenjash në shëtitjet e saj me të buzë detit paraditeve, të dy me rroba banje, dhe në shëtitjet e pasditeve, të dy të veshur, ndërsa ecnin bregut deri në afërsi të shpellave herë duke biseduar e herë të heshtur, ai duke kundruar profilin e saj të mahnitshëm dhe duke e kapur nga mjekra për t'ia kthyer fytyrën nga vetja, kur i dukej se ajo e kishte mendjen gjetkë, kurse ajo gjithnjë me mendjen tek ai.

Djathtas tyre shpalosej bukuria eterike e perëndimit me kaleidoskopin e reve me shirita të artë e me diskun e diellit që prekte horizontin e lëbyrur, me anijet që dukeshin të palëvizshme mes rrezatimesh verbuese dhe me konturet e blujta e të platinta të ishujve të vegjël që ravijëzoheshin në horizont, por ajo nuk e kishte mendjen tek ajo bukuri. Ajo ndihej si një flutur në praninë e tij dhe mezi e mposhtte dalldinë për t'u shtrënguar sërish pas tij sa herë që çikeshin padashur dhe donte të mos ndaheshin kurrë dhe kur shtrihej në krevat prekte pjesët e trupit që kishin prekur trupin e tij dhe ëndërronte që ai ta puthte. E dëshironte puthjen, por ai nuk e kishte puthur. As në det, kur laheshin e loznin me fytyrat ngjitur. Pse nuk e puthte?

Kjo i dukej e habitshme, pezmatuese, dhe i vinte turp t'ia kërkonte. Po sikur ta puthte vetë?, mendonte me drithërimë.

Një ditë u shfaq një vajzë emrin Ornela, me trup të bukur, hundë majuke me një kokrrizë pirsing. Ishte nga Arecoja, bënte plazh me familjen dhe krijonte rreth vetes një brambulli të hareshme. U miqësua me Lorin, laheshin bashkë, luanin volejball e hanin akulllore.

Ornela nuk kishte qejf të shoqërohej me Luixhin dhe kur ndodheshin të tre e tallte ose donte ta largonte. Një ditë notuan të dyja larg bregut, u lodhën e qëndruan në ujë duke parë një peshkarexhë. Papritmas ajo iu vërsul Lorit, u ngjit trup e kofshë me të, i vuri duart prapa kokës dhe e puthi. Për një fragment sekonde Lori e mendoi shmangien dhe kujtoi se qe tërhequr në kohë duke i shpëtuar veprimit të çuditshëm të tjetrës, kurse në të vërtetë qëndronte me buzët të ngjitura në buzët e saj, çka i shkaktoi një ndjesi sa të këndshme, aq edhe të frikshme.

Sirenë e egër deti, i kishte vetuar në mendje dhe e kishte shtyrë, kurse ajo kishte qeshur e kishte thënë, Sa e ëmbël është një puthje e kripur! Dhe ishte nisur drejt bregut. Pas saj ishte nisur edhe Lori ende me shijen e puthjes në buzë dhe që, për tmerrin dhe habinë e saj, i kishte pëlqyer. Bile një çast - këtë e kujtonte fare mirë - kishte dashur ta arrinte Ornelën për t'u puthur përsëri. Ëndje e përçudur, kishte menduar, bash si vetëledhatimi fshehtarak nator, si vënia e duarve mbi rrumbullsinë e gjinjëve dhe të kofshëve të veta. Por qe përmbajtur dhe e kishte përbuzur veten për këtë mendim të gërditshëm. Por edhe ndjellës. Epshore, e kishte sharë veten.

Megjithatë, kur doli nga deti e shihte me lakmi Ornelën që fshihej me peshqir e ngazëllyer dhe përsëri i erdhi ndot. Por kjo nuk ia hoqi etin për të shkuar e për të zhytur fytyrën mes kofshëve të saj të bukura, një ndjesi që i vrundulloi deri kur mbërriti Luixhi. Vështrimi, buzëqeshja dhe trupi i tij mashkullor bënë që ta harronte Ornelën dhe të ndërjegjej për drithëtirën që ndiente për të. Ajo e rrëmbeu nga krahu dhe u nisën bregut.

Shkuan deri te një grykajë e mbushur manxuranë e veronikë, hynë në një gorrë e qëndruan pranë një valanidhi të vogël që kishte mbirë buzë rrëpirës. Në atë humbellë deti krijonte një gji të vogël. Më tej nuk shkohej, se bregu ishte i thiktë. Nga jahti i tyre ajo kishte parë shpellat e *Fortino Grotte*-s që gufoseshin në rrëpirë. Ishte një vend i fshehtë, belban, me një gjelbërim të buhishëm nga ku dukeshin vetëm qielli, kullusma ku rrinin të dy dhe deti. Ajo ndiente fërfërimën e gjethnajës, shurukamën e valëve që lëpinin shkëmbenjtë, cicërimat e zogjve dhe hukamën e tij fare pranë fytyrës së saj dhe ishte gati të zhvishej e ta tërhiqte mbi vete. Por nuk bëri asgjë. Rrinte e heshtur, e tallazitur, duke dëgjuar të rrahurat e zemrës.

Papritur ai e kapi nga supet dhe e puthi. Ajo u drodh. Dhe nuk ia shqiti buzët. Ishte një njomësi dehëse dhe qenia e saj u bë puthje

dhe gjithçka tjetër në ekzistencën e botës u kthye në puthje dhe kishte diçka të gjithëkohshme në atë puthje që sikur rrënjoi nga mosgjëja dhe llokoçitjet e valëshkumave nëpër shkëmbenjtë e teposhtëm u kthyen në puthje dhe deti u kthye në puthje dhe kur shkëputën buzët ajo e pa me mirënjohje: ai ia kishte pastruar nga diçka që nuk mund të pastrohej ndryshe.

Ajo po i afrohej *Valle Pianës* dhe u ndërmend. Kaloi një urë, kaloi përbri Statujës së Shenjtë dhe ja ku u dukën ndërtesat e para të qytetës. Eci në rrugën kryesore, parkoi makinën në afërsi të pjacës së Merkatos dhe pa orën. Ishte ende herët për shfaqjen e parë të seancës së paradites në *Sala Truffaut* - një film danez. U drejtua për te kafeneja që ndodhej pranë atij shatërvani me cirkima këngëzuese. I pihej një kafe në vetmi, ndonëse shpesh rrethohej nga miq e të njohur, shumica gazetarë, por edhe regjisorë e producentë.

Atë kohë hynë Xheki me Marion e me dy-tre të tjerë. Ai u bë gati ta linte grupin, por ajo i bëri shenjë se kishte për të shkruar. Në të vërtetë kishte, por nuk i bëhej të shkruante. Shumë nga artikujt i shkruante në kafe. Qenke si Heminguej, i kishte thënë Xheki vitin e parë të njohjes dhe ajo kishte qeshur.

Para ardhjes në festival, në kohën kur në Napoli kishte shkuar Xheki, ajo kishte botuar një koment për filmin *The Rain Man* që sapo kishte dalë ku theksonte lojën e mahnitshme të Dustin Hofmanit, por thoshte se edhe Tom Kruzi ishte i jashtëzakonshëm. E kishin lëvduar për atë shkrim. Ajo ia kishte dhënë gazetën Xhekit, që e kishte lexuar me ndihmën e Marios. Kur ia kishte kthyer, sytë i kishte të gapërruar. Mrekulli, i kishte pëshpëritur. Nuk e dija se kishe ndjesi kaq të holla. Ajo kishte buzëqeshur, ia kishte falur gazetën dhe ai qe lumturuar. Me gjithë padëshirën, nisi të shkruante. Për një çast e ndali dorën, se në tryezë erdhi Xheki. Ai nuk bëzajti, vetëm hoqi panamanë dhe i bëri shenjë të vazhdonte. Ajo shkruante e i hidhte nga një sy. Krifa e flokëve të tij sikur grafullohej nga erërat e prerive që fqinjërojnë me shkretëtirat dhe bartte aromën e ujërave të gjelbra të mbushura me krokodilë ku ai qe larë dhe në tërë figurën e tij mbizotëronte hija e një autoktoni të lashtë, që më pak se gjithçka të kujtonte krokodilin, por që prapë ruante diçka primitive, të egër e të frikshme, ndonëse të zbutur nga qytetërimi. Figura e tij rrezonte forcë dhe kumtin e lashtë parak për thithje buzësh, thimthash e pubisi dhe etjen e shkretëtirës për shkarkimin e një rrësheku të mbushur me elektricitet këndellës. Ajo rrinte në beft për atë këndellje, por kishte frikë - a nuk kanë shtjella të frikshme lumenjtë

e rrëmbyer? Ajo i frikej pasionit të tij. Kurrfarë kërcënimi tjetër nuk shenjohej tek ajo fytyrë e hijshme me atë mjekër të gjatë një bërzhik. Ishte me trup të fuqishëm mashkullor (jovirtual, si të Pamelës) dhe këtu ishte e keqja - në dalldinë e pasionit ai mund ta flakte kontrceptivin dhe ta shkarkonte rrufenë e tij gjer në fund. Kurse atë e tmerronte një shtatzëni jashtë martesë. Kjo ishte ajo vorbulla e frikshme.

Xheki u ngrit për të ikur. Mirëpo iu kujtua diçka, u kthye, përkuli kokën e tij të madhe drejt saj e i tha:

- Më fal për ndërprerjen, Lori, por dua të të them se të kam sjellë një dhuratë.

- Ç'dhuratë?

- Është surprizë.

Ajo i dhuroi një buzëqeshje dhe Xheki iku. Ajo e la të shkruarit. Ndoshta e tepronte me frikën e egërsisë që i dukej se rrënjonte prej tij. Ai do ta respektonte marrëveshjen. Mund të shkonin edhe në hotelin e saj në Salerno. Sa për Pamelën, nuk do ta vriste fort mendjen. Që prej flirtit me redaktorin e rubrikës së verdhë në gazetën ku punonte nuk e kishte tradhtuar më, por nuk mendonte të rrinte përgjithnjë me të. Edhe pse Pamela ishte kokëkrisur dhe përpara njohjes së tyre kishte bërë dy tentativa për vetëvrasje, nuk i trembej. Në vaskën e banjës apo në krevat Pamela ishte e përkryer dhe vrushkullimi i saj e rrëqethte, por më pas e urrente, ndihej në prag të vetëvrasjes dhe kjo e tmerronte. Ishte edhe nënndjesia e poshtëritit, një kllapuritje e paçanësuar si një vrashpirtje e hidhët që e shtynte të ndahej me të dhe të ëndërritej për një mashkull që në mos do të ishte më shkundullues nga ç'arrinte potencia erotike e Pamelës, të paktën do të ishte ajo çka kërkonte etshëm rrembi i saj femëror.

Pa orën, futi bllokun në çantë dhe u ngrit. Hyri në kinema dhe u habit që nuk i kujtohej filmi danez. Me siguri në përzgjedhje nuk do ta kishte parë. Kurse ai filmi shqiptar i kujtohej qartë. Më qartë se çdo tjetër nga qindra e qindra që kishte parë në periudhën e përzgjedhjes. Sa keq që aktorët kryesorë zakonisht nuk ftoheshin.

### 3

Xhevahiri ende flinte kur ndjeu një tundje të lehtë te supi dhe zërin e butë e paksa të ngjirur të Nasit:

- Ushtar Xhani, çohu!

Ai ndeshi vështrimin e qeshur të shokut, hodhi shikimin nga dritarja dhe për disa çaste qëndroi pa lëvizur. Thanas Karbunara, piktor filmi, një tip i zeshkët, me flokët drudhë e me një fytyrë plloçake, ku i spikatnin sytë e zez e përherë dashamirës, ishte rreth të tridhjetë e pesave. Ai drejtoi trupin e vazhdoi:

- Të kujtohet një shprehje që e kemi lexuar dikur në histori: *Çohu kont, se të presin vepra të mëdha?*

- Shumë të mëdha, baron Karbunara, - ia ktheu Xhevahiri duke u shtriquar. Dhe papritur ia dha gazit. Nasi e pa me habi.

- M'u kujtua si t'u qep ajo kurva...

- Unë thashë ç'pate! Pse, ty s't'u qepën?

Një ditë më parë, në Romë, vinin vërdallë nëpër Termini pa ditur ç'të bënin, se treni donte kohë të nisej. Trotuari përtej gëlonte nga prostitutat. Dalloheshin nga veshja, nga qëndrimi, nga mënyra se si u qepeshin meshkujve, por ata nuk e kapën menjëherë se ç'ishin. Xhevahiri u befasua kur njëra i zuri rrugën e i tha, *Vieni, caro, un brivido di piacere per 20 milla lire*. Ishte brune, simpatike, fare e re, e veshur me një zhapone të tejdukshme, me minifund, me kapele cohe të gjerë, buzë e sy lyer e ngiyer. Ai mbeti për një hop i hutuar, por e mblodhi veten dhe i shkau. Kaloi rrotull bërrylit të rrugës dhe priti për Nasin. Atë kohë pa dy të tjera që po vinin drejt tij. Ia mbathi përsëri dhe u hodh në trotuarin tjetër. Që atje pa njërën që jepte e merrte me Nasin, e mbante nga krahu dhe nuk e lëshonte. Ai iu shkëput nja dy herë, por ajo e ndiqte. Kur iu shkëput përfundimisht erdhi te Xhevahiri i leqendisur e qull në djersë. Kurval! M'u qep e s'më lëshonte.

- Sa të kërkoi?

- 20 mijë. *Vente mila* aq janë?

- Aq.

- Pastaj tha *kundiçi*. Pesëmbëdhjetë?

- Po.

- Po ku kemi ne? Lesh kemi.

Ende duke vazhduar të qeshte Xhevahiri u ngrit. Të dy ishin pjesëmarrës në festival dhe i kishin akomoduar në Batipalia, në një hotel me dy yje. Caktimi i Xhevahirit në festival kishte qenë i papritur. Në festival do të vinte Ramiz Kumi, regjisori i filmit pjesëmarrës, por përpara nisjes ai qe operuar. Caktimet për të shkuar jashtë shtetit bëheshin prapa kulisave, ku midis përkrahësve të kanakarëve të ndryshëm zhvillohej një luftë e ashpër. Kandidaturën tënde do ta

ketë mbështetur Triumfi, i kishte thënë Nasi. Ti di italisht dhe i duhesh si përkthyes. Xhevahirit s'i prishte punë; ishte hera e parë që dilte jashtë shtetit dhe i qe bërë qejfi që e kishin caktuar. Përkthimi nuk i qe vënë si detyrë, vetëm nënkuptohej. Për të kishte qenë punë shansi, kurse për Thanasin do të kishin vënë dorën në zemër: ishte piktor i disa filmave, kishte hapur dy ekspozita e megjithatë nuk e kishin çuar në asnjë festival.

Triumf Gjoka ishte pjesëmarrësi i tretë dhe kishte ardhur në Itali katër ditë përpara tyre. E kishin akomoduar në një hotel me katër yje në Salerno, sepse megjithëse ishte drejtor prodhimi, në festival vinte nën petkun e Drejtorit Artistik. Për drejtuesit e festivalit ky titull mjaftonte që ta përfshinin në listën e mysafirëve të shquar, ndaj i kishin dhënë një dhomë luksoze me televizor e me frigorifer të mbushur me pije. (Triumfi ishte edhe kandidat i Komitetit Qendror të Partisë dhe kryetar i Frontit të lagjes, po për këto ofiqe në festival s'pyste kush).

S'kishin shumë që qenë ulur në restorant kur panë Triumfin duke ardhur drejt tyre. Me siguri do ta kishin sjellë nga Salernoja me veturë. Sa shpejt e paska ngrënë mëngjesin, pëshpëriti Xhevahiri. Triumfi mezi i zhgrapte dy fjalë italisht dhe mbrëmjen e kaluar, kur Xhevahiri dhe Nasi sapo kishin mbërritur në *Valle Piana* të lodhur, e kishte marrë Xhevahirin si përkthyes në një takim me rëndësi. Xhevahiri fliste e lexonte mirë italisht, kishte mbaruar edhe metodat e anglishtes *Essential*.

- Folën mirë për filmin tonë, - iu drejtua Triumfi Nasit dhe mbushi një filxhan me kafë që e dëndi me pesë a gjashtë lugë sheqer. - Të tha Xhevahiri?

- Po.

Nasi e kishte kaluar mbrëmjen me ekipin e Televizionit Shqiptar që do të xhironte aspekte nga festivali. Ekipi kishte ardhur nga Greqia në Bari me traget duke sjellë edhe një xhips dhe kishte mbërritur në *Valle Piana* një ditë më parë. Edhe ata i kishin akomoduar në Batipalia.

- Të zotët e shtëpisë u flasin mirë të gjithëve, - tha Xhevahiri.

- Por folën me entuziazëm. Ti i dëgjove vetë.

- Rëndësi ka gjykimi i fëmijëve. Ata vendosin.

- Kanë për ta pëlqyer, - tha Triumfi duke shtënë prapë kafë në filxhan.

- Rëndësi ka që e përzgjedhën për konkurrim, - tha Nasi.

- Rëndësi ka çmimi, - tha Triumfi. - Se e meriton. Është një film



nga i cili kanë ç'mësojnë edhe borgjezët po qe se duan.

Xhevahiri e kishte tmerr bisedën me atë kapitullar partiak me kokën të mbushur me serum ideologjik. Kishte fytyrë të pashme, flokë paksa të thinjur, sy ngjyrë smeraldi, buzë të trasha, të gatshme për të prodhuar njëfarë buzëqeshjeje partiako-babaxhane, që s'ishte tjetër veçse një buzëqeshje kinse kameradeske. Ishte kjo buzëqeshje që i ngjallte Xhevahirit një frikë instinktive dhe sepse i kujtonte arrestimet në mes të natës.

Xhevahiri e dinte euforinë e Triumfit për filmin, por nuk dinte ambicien e tij për çmim. Kur filmi ishte diskutuar në kolektiv ai kishte thënë se ...shënonte një fazë të re në kinematografinë tonë. Kurse Xhevahiri kishte rezerva për atë film ku ishte as/regjisor dhe aktor.

Dolën nga restoranti dhe hipën në një autobus luksoz (që italianët i thoshin pullman) për të shkuar në *Valle Piana*. Në gjithë atë autobus nuk qenë më shumë se 20 të ftuar. Ndihej një erë e lehtë deodoranti, diçka midis lules së pjeshkës dhe mentes. Xhevahiri u ul me Nasin, prapa tyre u ul Triumfi, kurse në sediljen përpara një plakë te të shtatëdhjetat e ndihmuar nga një vajzë. Xhevahirit i kapi veshi pjesë nga biseda e tyre anglisht.

Plaka u kthye papritur nga ata. Kishte një fytyrë të qeshur dhe syzet e mëdha sikur e rinonin. Jam regjisore, u tha, vij nga Shtetet e Bashkuara. Po ju? Nasi nuk merrte vesh anglisht, kurse Xhevahiri ia ktheu përgjigjen me mirësjellje. Plaka e pyeti për ç'kategori e kishin filmin dhe ai i tha, *Free to Fly*.

Oh, u gëzua ajo. Kam bërë shumë filma për atë moshë. Këtë herë e kam për *Y-Gen*.

Ai s'e kapi menjëherë ç'tha ajo dhe ajo ia përsëriti, e kishte fjalën për gjininë e filmit *Young Generation* për moshën 14-18 vjeç dhe ai pohoi me kokë. Atij i pëlqeu biseda me atë grua të moshuar e të qeshur, me flokët ngjyrë argjendi, e veshur me një bluzë byrinxhyku të hollë me dizeno dhe me një erë të lehtë lule livandoje.

- Do ta shoh filmin tuaj. - Ajo i dha programin. - Lutem nënvizoni titullin.

Xhevahiri e mori dhe ia nënvizoi. Ajo i kërkoi kopjen e tij të programit që edhe ajo të shënonte titullin e filmit të saj dhe ai ia zgjati. E mori vajza që e hapi dhe shënoi një titull me flamastër të kuqe. Xhevahiri e pyeti regjisoren se ku i gjente skenarët.

- Nga shumë burime. Nga fantazia ime, nga kujtimet e fëminisë dhe të adoleshencës, nga letërsia. I sugjeroj, nuk i shkruaj vetë. Po ju?

- Pak a shumë.

Plaka zuri të rrëmonte prapë në çantë. E ndihmuar nga vajza nxori një kartëvizitë dhe ia zgjati. Kartëvizita ime, i tha. Mbase vini në Amerikë. Mos ngurroni të trokisni në shtëpinë time në çdo orë të ditës e të natës.

Xhevahiri u habit me dashamirësinë e saj. Triumfi përkuli kokën drejt tij dhe e pyeti, Nga janë ato? Nga SHBA. Si?!, krokati zëri i tërbuar i Triumfit. Qenkan prej andej dhe vazhdon? Mos u fol më!

Xhevahiri u drodh. Dhe e ktheu kokën nga ai vetëm përgjysmë. Nuk ia pa sytë, por e merrte me mend se ata do të ishin aq të egërsuar, sa të fusnin datën. Ky është i aftë të shkatërrojë jo më një bisedë të çiltër, por një jetë të tërë, mendoi. Megjithatë gojën do ta qep, se ndryshe ka rrezik të më arrestojnë sa të hyj në kufi. Si dreqin s'e vrava mendjen që e kisha pas? Apo u nisa nga mendimi naiv se në festival politika sfumohet pakëz në favor të marrëdhënieve miqësore... Ndodhi dhe aq papritur, dreqi. Dhe krejt natyrshëm. Mirëpo ky kokëbigorr mund ta ndiejë për detyrë, ose e ka për detyrë, të më kallëzojë. Mua mirë ma bëri, por do të bënte mirë të shihte edhe veten. Se ka marrë statusin e personalitetit të kinemasë pa i ardhur turp për këtë mashtrim.

Triumfi i kërkoi kartëvizitën e regjisores dhe ai ia dha. Pas pak dëgjoi ca kërcëritje. Idiota. Po sikur ajo të jetë gabuar, të më ketë dhënë një kartëvizitë tjetër, të ma kërkojë përsëri për të më dhënë të duhurën? Nuk priti të paktën sa të zbrisnim?

Iu kujtuan kartëvizitat që kishte në xhep. Leskra me sigla e vinjetka të denja për varret e humbëtirta të shpresave idioteske. Atij dhe Nasit u kishin bërë nga 20 copë falas për t'ua dhënë personaliteteve me të cilët mund të njiheshin, por me kusht që të ishin dashamirës të vendit të tyre. Tani ishte e pamundur që t'ia jepte kartëvizitën amerikanës. Frika e mbijetesës shkul me rrënjë çdo filiz miqësie.

Regjisorja u kthye nga ai dhe e pyeti për diçka. Ai bëri një gjest të dëshpëruar me sy e me buzë, por ajo dhe vajza e panë me hutim. Zonja të dashura, nuk keni faj që s'më kuptoni dot dhe as unë s'kam faj që nuk shpjegohem dot. Unë vij nga një vend ku mbizotëron absurdi. Ku njerëzit detyrohen që njerëz si ju t'ju quajnë armiq, edhe pse ju s'jeni armiq. Dhe t'ju bëjnë me dije se janë armiq të tuaj, edhe pse s'janë. Në atë vend, që është në bregun e përtejme të një deti të ngushtë që lidh këtë gadishull me një tjetër ndodhin çudi më të çuditshme se ato në *Liza në Botën e Çudirave* që ju mund ta keni bërë film. Dhe s'janë çudi të këndshme komike, por çudi tmerri. Në atë breg sundon

një regjim i pabesueshëm dhe nëse Liza do të shkonte atje, ka të ngjarë ta quante *Bregu i Absurdit*. Unë vij prej andej, të dashura zonja, ndaj nuk kam asnjë mundësi të flas më me ju. Unë për një çast harrova se nga vija dhe kjo është fatkeqësia ime. Situata ime e pjerdhur.

Me të zbritur në *Valle Piana* i doli regjisores ballas dhe fshehtas Triumfit formoi me mimikë sinjalin më të mundshëm të kuptueshëm se atij nuk i lejohej të bisedonte me të dhe i buzëqeshi. Ajo duket kuptoi diçka. Po me mimikë ai i dha përshëndetjen e ndarjes dhe eci pas Nasit. Triumfi kishte ndaluar afër shatërvanit dhe i bëri shenjë me gisht t'i shkonte pranë.

- Me amerikanët, anglezët, izraelitët e rusët nuk na lejohet të këmbejmë asnjë fjalë! Nuk e di këtë?

I bërë tym dhe duke mposhtur dëshirën për t'i dhënë një grusht turinjve Xhevahiri belbëzoi një pohim. Triumfi u kthye dhe u bashkua me ekipin e Televizionit Shqiptar. Ata qenë ulur në një nga tryezat e vëna në trotuar nën çadra dielli. Ishin pesë veta: një grua me detyrë redaktore dhe katër burra të rinj: shoferi, kameramani, skenaristi dhe tekniku i zërit. Edhe ata e kishin për herë të parë që dilnin jashtë shtetit.

Nuk i bëhej të bashkohej me grupin e tyre nga shkaku i Triumfit. Deri në orën 9:00, kur fillonte seanca e shfaqjeve, donte dhe një orë. I tha Nasit të hidhnin një sy nëpër qytezë, por Nasin e thirri një nga ata të Televizionit. E detyroi veten ta harronte turbullimin që i kishte shkaktuar incidenti me Triumfin dhe nisi të çapitej duke kundruar ndërtesat, ballkonet me lule, dritaret e lara në dritën mëngjesore, kodrat e mbytura në gjelbërim dhe një kishë që ngrihej në skaj të qytezës. Vetrinat të merrnin sytë dhe dyqanet pëlcisnin nga mallrat. Po afrohej dhjetëvjeçari i fundit të shekullit të 20-të dhe shitoret në atdhe ishin dëshpërimisht të varfra. Të dhimbnin sytë nga pamja e rafteve bosh, një pamje mjerimi migjenian.

Kontakti me Perëndimin e kishte tronditur. Pamja e aeroportit *Fiumicino*, bollëku shkundullues i mallrave rreth stacionit Termini dhe në shitoret në Romë, me aq sa panë, arat e sëritura, duajt cilindrikë, qytetet dhe të visoret që shihnin nga treni kishin qenë jashtë përfytyrimit të tij. Gjithçka ishte reale dhe fajshmërisht ngashënjese. E kishte tronditur thellë përballja me një realitet që ia kishin nxirë. Dhe mashtrimi se vetëm vendi i tij ndriste në botë i qe dukur i përbindshëm. Kur e vërteta ishte se në atë vend jetonte një popull i mjerë dhe i uritur.

I kishin dhënë tri rroga paradhënie për të blerë veshje që bytha e shtetit lavdiplotë prej nga vinte të mos dukej e menderosur, siç ishte. Paratë që i kishin tepruar, bashkë me ca kursime, i kishte këmbyer fshehtas, nën tmerrin e frikës, me 100 dollarë. Kishte prindërit dhe dy motra, por edhe miqve duhej t'u çonte diçka. Të shkoje jashtë shtetit e të mos sillje gjë, një çakmak a ca çimçakizë, krijonte qejfmbetje. Shumë mallra nuk gjendeshin, po dhe ato që gjendeshin ishin të shtrenjta.

Tortura më e madhe nuk kishte qenë blerja e dollarëve, por se si do t'i kalonte në doganë, pasi kishte dëgjuar se atje të bënin

kontroll dhe po që se t'i gjenin t'i konfiskonin dhe kishe pasoja. Bleu një bllok shënimesh me kapakët të përbërë nga dy kartona, i ndau kartonat, futi kartëmonedhën midis tyre dhe i ngjiti buzët me vinovil. Në të vërtetë nuk i bënë kontroll.

Dieta ditore për pare xhepi ishte sa për një kafe e një kanaçe koka-kola dhe si ai, si Nasi, e hiqnin hollë për t'i kursyer dhe ato. Nuk e harronte që teksa vinin me tren nga Roma në Salerno bënte një vapë e zabullimtë, ata rrinin ulur në kupe me gojën eshkë nga etja dhe nuk blenë një shishe me ujë akull të ftohtë te shitësit që ecnin përgjatë mesores duke i rënë ziles. Ç'idiotë u treguam, i pohuan shoku-shokut më pas.

Ai kishte sjellë me vete dy steka me paketa Arbëria, ndër më të shtrenjtat në treg, dhe dy llulla, prodhim i artizanëve të Krujës. I kishin thënë se mund të zinte ndonjë mik nga ndonjë vend i lejueshëm e mund të shkëmbenin dhurata. Por pas ngjarjes në autobus mendonte se si zor të zinte miqësi aty. Ndaj nuk dinte ç'të bënte as me cigaret, se vetë pinte duhan të hapur Tarabosh, as me llullat.

Ishte koha e fillimit të shfaqjes së filmit që hapte festivalin në kinemanë *Sala Valle*, që sot edhe do të përurohej. Në mbrëmje, në kinemanë verore Maison Lumiere, do të bëhej ceremonia e hapjes së festivalit. Triumfi i kishte porositur që t'i shihnin të gjithë filmat, edhe ata amerikanë, anglezë, izraelitë apo rusë. Duhet t'i njohim prodhimet e tyre, u kishte thënë, që t'i diskreditojmë në shtyp.

## 4

Në kinema u ul me Nasin. Filmi nuk u bëri përshtypje, por as u mërzitën. U shfaqën edhe dy të animuar dhe seanca e paradites u mbyll. Në orën 11 fillonte ceremonia e përrurimit.

Doli jashtë me Nasin dhe ndezi një cigare. Nisën të vinin të ftuarit me emblemat e festivalit në gjoks. Erdhi i gjithë grupi i Televizionit e me ta edhe Triumfi. Salla u mbush dhe pas pak hyri Xhulio Andreoti, kryeministri i Italisë. U thanë fjalët e zakonshme të përrurimit, përrshëndeti kryeministri dhe nisi shfaqja e një filmi klasik.

Pasdite ishte filmi i tyre, që titullohej *Heroi i Fshatit*. Synopsin në anglisht, që ishte vënë në katalog, e kishte përkthyer vetë. Filmi bënte fjalë për disa studentë që hapin tarraca në një fshat malor në pushimet verore dhe një mësues vendas organizon fëmijët të punojnë me ta. Prindërit nuk i lënë fëmijët, i duan për punët me bagëtinë, por komunistët i quajnë individualistë, u bëjnë trysni, ata frikësohen dhe detyrohen t'i lënë. Një djalë i fshatit plagoset në punë dhe me gjithë përpjekjet e mjekëve, vdes. Fshati është krenar që ka rritur një hero.

Ishte rregull që përpara shfaqjes regjisor i producenti i filmit dilte përpara auditorit, gazetarëve dhe jurisë për të thënë diçka. Juria përbëhej nga fëmijë të ardhur nga Italia dhe vende të tjera. Xhevahiri mori mikrofonin dhe nisi të fliste duke iu marrë goja nga emocioni. Prezantuesit, një burrë i pashëm, korrozi e i gjallë dhe një vajzë e hijshme, e gjatë dhe e qeshur, e ndihmonin. Ai u përqendrua te puna me lojën e fëmijëve.

Ndërsa fliste i shkuan sytë te gazetarët, që rrinin në radhën e parë. Mes tyre i tërhoqi vështrimin fytyra e një vajze që po e shihte me sy të zhgapërryer. Ai pa se si ajo u mat të shënonte diçka në bllok, por dora i mbeti pezull. E hoqi vështrimin prej saj dhe vazhdoi të fliste, po kur i hodhi sytë sërish nga ajo, pa e ditur as vetë përse, pa se ajo vazhdonte ta shihte me një vështrim jonormal, a thua se po shihte një fantazmë. Nga largësia prej dy metrash ku ndodhej vuri re se ajo ishte çuditërisht e bukur.

I shajnitur mezi bërbeliste ndonjë fjalë dhe prapë i hidhte sytë nga vajza duke vrarë mendjen përse ajo qe turbulluar dhe a kishte lidhje ky turbullim me të folurit e tij mëkmëk? U hutua dhe harroi ç'qe matur të thoshte. Me gjithë nxitjet e prezantuesve tha se nuk kishte gjë për të shtuar, përrshëndeti dhe u largua me mendjen tek ajo vajza që e kishte habitur sa me turbullimin, aq edhe me bukurinë e saj. Kur

mbërriti në kalimin anësor, ku e priste Nasi, i hodhi vajzës një vështrim të fundit dhe mendoi se ndoshta nuk ishte gazetarë, por aktore.

Gazetarët u ngritën për të shkuar në rreshtin e caktuar për ta. Nasi tha se meqë Triumfi nuk ishte, nuk do të rrinte në film. Xhevahiri nuk mund të largohej, se mund ta merrte vesh Triumfi dhe e bënte për një lek. Veç kësaj, pas shfaqjes mund ta kërkonte ndonjë gazetar a fëmijë nga juria. Madje duhej të dëgjonte edhe diskutimet e fëmijëve.

Salla qe mbushur më pak se gjysma. Ai u ul nga fundi, krejt i vetëm në gjithë atë hapësirë bosh. Ende pa u fikur dritat ndjeu një fëshfërimë, ktheu kokën dhe u habit, madje u trondit, kur pa atë gazetaren apo aktoren që i erdhi pranë, e përshëndeti lehtë me kokë dhe u ul në karrigen ngjitur me të tijën. Ai mbeti si i shastisur.

Tani, nga aq afër, e pa më mirë. Ishte vërtet e bukur - flokë të zez lëshuar supeve, sy po të zez, hundë e derdhur, buzë të fryra, mjekërz të skalitur me një lakore që derdhej ëmbël në qafën e gjatë dhe gjinj të gufmuar nën bluzën e bardhë me riga. Ai ndjeu një kundërmim erzine që i shkaktoi një shtjellë dehëse, por ndjesia më e fortë ishte ëmbëlsia që rrënjonte prej saj. Në një çast kthyen kokat nga njëri-tjetri dhe ai sikur shqoi një ethërimë në sytë e saj. Pastaj ajo drejtoi fytyrën dhe atij i mjaftoi një grimë kohe për ta kundruar në profil. Ç'mrekulli nuk sajton natyra edhe me profilet, mendoi. Kjo më bind se as skulptori më gjenial i botës, për shembull anonimi i *Venerës së Milos*, nuk e ka arritur dot natyrën. Nëse gdhendjen nuk e bën natyra, por Zoti, kuptohet që Zoti nuk do ta ketë vrarë mendjen shumë për bukurinë kur gatiti Evën shpejt e shpejt ngaqë Adami, i gjori, ishte vetëm. Duke parë të metat e saj me kohë e ka përsosur femrën deri te kjo.

Drejtoi fytyrën dhe ja ku pa veten në ekran duke ecur rrugës së fshatit. Me ato pantallona doku, me xhakëtën hedhur supit e me kasketën mbi sy dukej si llosh. Sa pak dubla më bënte Ramizi, mendoi. Kurse fëmijëve shumë. Ndërkohë mbeti pa frymë: diçka i rrëshqiti zgriptazi në ije gjersa i preku dorën. Oh. Dora e saj. Sa e butë.

Nuk duhet të jetë në vete, mendoi. Ose është ndarë nga i dashuri dhe kërkon dëshpërimisht harrimin, ose është ndonjë xhadi që i ngjitet çdo mashkulli pranë të cilit ndodhet. Ndodhet?! Nuk u ndodh, por erdhi vetë. Të ishte salla plot e të qemë ndodhur rastësisht pranë e pranë, epo hajde. Kurse e gjithë radha është bosh, madje janë bosh edhe nja dhjetë të tjera. Ajo erdhi vetë. Po pse? Një fjalë goje është ta quash xhadi, po si mund të jetë e tillë një vajzë që mbahet aq thjesht dhe për më tepër pse do të ishte në mes të gazetarëve?

Gjithçka që ndodhi gjatë filmit shkoi përtej së besueshmes. Ai u kthye në adoleshencë, kur i fuste duart ndonjë shoqeje të klasës, por tani me një ndjesi të paprovuar kurrë. Përballë furisë së pasionit vitet ngjishen si në një implozion yjor. Në ashkun e tij ka vetëm të tashme dhe arsyeja, sikurse vitet, bëhet zero.

Ai ndjeu krahun e saj të zhveshur të prekte krahun e tij dhe ai nisi t'ia ledhatonte atë cipë lëmuar. Ledha është formula magjike që i pëshpërit lëkura lëkurës, është puthja e prekjes, kodi që hap derën e kripteve të dashurisë. Ajo iu mbështet në sup dhe ai ndjeu ethërimën e hukamës së saj. I futi dorën nën bluzë dhe nisi t'i përkëdhelte gjinjtë, belin poshtë bluzës, kofshët e gjata nën xhinset e shkurtra dhe vetëm një shkëndijë e arsyes e mbajti të mos e puthte, por ajo, siç duket, e kishte humbur atë grimë arsyeje sepse u zgjat drejt tij, i vuri dorën në qafë dhe e puthi. Pastaj u kthye nga ekrani.

I pëlqeu puthja e saj, por edhe e shkundulloi. E ka vënë dikush të më përdhë mendjen? Tamam si te filmi i Trufoit *Gruaja me të Zeza*. Siç ul kjo pranë meje edhe ajo, Zholi më duket e quanin, ulet pranë njërit prej atyre që i kishin vrarë të shoqin dhe pas shfaqjes shëtisin bashkë. Për ta futur në kurth, kuptohet, kurse ai trapi pandehu se asaj ia kishte qejfi. Kjo s'besoj të ketë ndërmend gjë të keqe, po kush drejtin e di?

Filmi po mbaronte dhe me të do të merrte fund edhe magjepsja e atij çapëlimi marrëzisht erotik me një të panjohur. Pavarësisht se kush drejtin ishte e ç'qëllim kishte, ëmbëlsia që gulfonte prej saj ishte e papërbalueshme dhe ai ndjeu se testosteroni i kishte shpërthyer buhishëm. Një forcë e mistershme e pengonte t'i shkëputej kurmit të saj të epshëm. Ç'më gjeti. Po do të më kalojë. Një ledhatim i rastit është. U bën vaki të gjithëve. Një dialog erotik i pazëshëm dhe pastaj as pafshim. Sikur s'ka ndodhur gjë. Se po t'i jap rëndësi duke menduar se diçka më serioze qëndron në këtë afrim të beftë, ka rrezik të idiotizohem. Mund të më bëhet fiksim t'i shkoj pas si i përhënur, kurse ajo as që do të më hedhë më sytë.

Filmi mbaroi dhe u ndezën dritat. U ngritën në të njëjtën kohë dhe u panë sy më sy. Fytyra e saj ethëronte. Madje një si dhembje pikturohej në të. Ajo zgjati dorën të merrte çantën që e kishte varur në anë të karriges, por e la në vend dhe vështrimet e tyre u kryqëzuan sërish. E bërë flakë ajo pëshpëriti, Mund të njihemi?

Spektatorët që nuk kishin interes për diskutimin po dilnin. Ai dhe e panjohura vazhdonin të qëndronin përballë njëri-tjetrit. Ajo

përsëri zgjati dorën te çanta dhe prapë s'e mori.

- *Che ne direbbe?*

Pati një lutje çmeritëse në atë pyetje dhe fytyrën ia mbuloi një zbehtësi vdekjeje. Duket lemerisht në ankth, mendoi ai, dhe, për çudi, akoma më e bukur. Më shikon sikur do të më përpijë dhe në sy i lexohet tmerri, a thua se një jo imja do ta dërrmojë. Eh, në ç'qerthull u futa.

Ajo e përsëdyti pyetjen dhe ai u ndërmend. Po, i tha thjesht. Ajo u mbush me frymë dhe në fytyrën e saj ai pa shprehjen e ringjalljes. Sytë i flakëritën nga një përshkënditje që një mashkulli i qëllon ta shohë vetëm një herë në jetë. Kurse në fytyrë ngazëllimi mugulloi i kursyer, si të kishte frikë të shfaqej i tëri se mos gllabërohej nga një asgjë rrënimtare.

- Jam Loredana Viskonti, - tha ajo dhe i zgjati dorën. - Shkurt më thonë Lori. Jam gazetarë. Emrin tuaj e di nga katalogu, po nuk jam e sigurt nëse e shqiptoj mirë.

- Xhevahir Xhani, - tha ai duke i shtrënguar dorën.

- Xhevair Xhani?

E shqiptoi emrin me droje, duke e ngrënë h-në.

- Xhevahir. Me *h*.

- Xhevahir, - shqiptoi ajo dhe u shtendos.

Dhe buzëqeshi. Me një buzëqeshje që çeli duke zbuluar një sërë dhëmbësh të bardhë dhe që iu përhap në fytyrë për t'iu përqendruar te sytë. Sapo e sheh në sy ajo të gozhdon, i vetoi atij rrufeshëm. Buzëqeshja në ta qëndroi më gjatë, si të ushqehej nga një tjetër më e thellë, që i buronte nga brenda. Në faqe iu formuan dy gropëza që ia hijeshuan fytyrën më shumë.

- Ka një *h* si në anglisht, ë?

- Po.

- Xhevahir... - Tani *h*-në e theksoi më fort se ç'duhej.

- Pak a shumë.

Ajo pa orën e dorës, mori çantën dhe e pa në sy.

O Zot. Edhe sikur një mijë vjet të jetoj, nuk di a do të shoh më sy të tillë.

- Do ta shihni filmin tjetër?

- Po. Pse?

- Nuk mund ta lini? Desha të thosha... sikur të shkonim diku. Është e mundur?

Ajo e shikonte me ankth, me një ankth që atij iu duk anormal,



madje paranojak. Ç'ka kështu, xhanëm?

- Po mirë, meqë dëshironi.

- Oh! - Ajo mori frymë thellë, si të kishte shpëtuar nga dënimi me vdekje. - Faleminderit. Shumë faleminderit. - Ajo e pa prapë orën e dorës dhe shtoi me një ngurrim të frikur: - Mund të takohemi te hyrja e kinemesë këtu në orën 6? Nuk do të ikja, por kam një punë me ngut. Mundeni?

- Mirë.

- Unë do të bëj çmos të mos vonohem... Do të më prisni?

Vështrimi i saj ishte lutës për siguri. Kishte diçka tronditëse në të, diçka ngashënjyese dhe të padeshifrueshme dhe njëherësh po aq frikëndjellëse, sa ai u kalamend. Po të jetë se bën lojë, qenka aktore e përsosur. E pakrahasueshme edhe me Manganon te *Oriz i Hidhur* që përgjërohet për atë horrin. Gasmani e luan atë? Ai u ndërmend dhe u kujtua se ajo priste përgjigje.

- Po.

Ajo u mbush me frymë, buzëqeshi, u kthye dhe iku me nxitim përgjatë mesores së ngushtë. Ai e ndoqi me sy derisa ajo doli dhe, për çudi, tani që ajo kishte ikur, ai e ndjeu edhe më kapërthyes atë turbullim gjakngrirës. Një bukuri e tillë... me atë trup të përkryer... me ato mise femërore të mistershme që m'i ekspozoi vetë, m'i dhuroi vetë, dhe që nuk e di pse e bëri... Një femër që ia kalon edhe Venerës së Botiçelit, që e shihja te katalogët e shokëve të mi të degës së pikturës. Femër tmerr. Po ku e ka hallin?

Tha se është gazetare, po mund të jetë edhe kurvë. Jo prostitutë, nga ato që e kanë zanat e nxjerrin bukën me të, po kurvë qejfi. Si te filmi i Bunjuelit *E Bukura e Ditës*. Asgjë s'i mungonte asaj - as paratë, as shtëpia luksoze, as ai alamet burri. Megjithatë hyri në bordel *part time*. Kjo mund të jetë e midisme: peshkon meshkuj edhe për qejf, edhe t'i zhvatur.

Nëse është kurvë, është pa dyshim kurva më e bukur që kam parë. Se mos kam parë shumë, xhanëm. Ato të Terminit të mira ishin, por as që i afroreshin kësaj. Po qe se ia ka qejfi pa para, bujrim. Po qe me para, e tha mirë Nasi, lesh kemi ne. Dhe që të vijë pa qëllim për të më zhvatur, si zor. Është tepër e bukur për ta dhuruar veten qyl. Aq më pak ka mundësi që të jetë ndonjë kurvë bamirëse për ne, fukarenjtë e lindjes.

Prezantuesi po e ftonte me dorë për të shkuar pranë podiumit, por ai ishte ende i hutuar. Fëmijët e jurisë ishin gati të fillonin diskutimin.

S'ka çudi të jetë kurvë. Ama kurvë klasi. Një femër aq e ëmbël, aq fine, aq ngashënjyese, aq hamgjitëse. Që ia pjerdh mendjen çdo mashkulli, le më një trapi si unë, që po se po. Dua të njihem me ju. Si urdhëroni, unë. Dua të shkojmë diku. Posi jo, zonjushë. Pa ditur gjë fare se ku i rreh asaj. Po sikur të më shohë Triumfi me të? T'ia mbath e mos t'i dal më përpara syve?

Diskutimi zgjati rreth gjysmë ore. Fëmijët e jurisë dukeshin të entuziazmuar. Loja e fëmijëve në film u kishte lënë mbresa, e të rinjve jo. Mësuesi luante bukur, por tekstin e kishte të dobët. Ai mezi kapte ndonjë fjali të plotë. I rrinte mendja tek ajo. Vetëm tek ajo.

Doli nga salla dhe pa orën. Donte dhe gjysmë ore që të vinte ajo. Ajo. Po kush dreqin ishte ajo?

Kërkonte Nasin me sy, por ai nuk dukej gjëkund. Nisi të bënte varavingo nëpër trotuar. Më në fund në anë të rrugës pa të ndalonte një Citroen të kuq. Në timon ishte Ajo. Ai e shikonte dhe nuk i bënin këmbët të lëvizte. Ndihej i tallazitur, i zhytur në atë dritë diellore ende lëbyrëse e prapëseprapë në terrinë. Zemra i rrihte me forcë. Me ritmin e kapsallitjes së syve të pataksur të Triumf Gjokës. Që mund të vinte në këtë kinema, *Sala Valle*, për të parë filmin e radhës. Apo mbase shkonte në *Giardino degli Aranci*? Po të vinte këtu me siguri do të pyeste Nasin për të. Ku e dinte Nasi se ku ishte ai?

## 5

Ajo nxori kokën nga dritarja e i thirri. Ai bëri sikur tani e pa. Ajo e ftonte me dorë nga xhami i hapur. Ai iu afrua me ndrojtje dhe e pa në sy në mënyrë pyetëse. Ajo vazhdonte të ethëronte si në kinema. Duhet të jetë e sëmurë, i vetoi atij rrufeshën po ai dyshim që i kishte vetuar edhe në kinema. Në atë kinema që ai e kishte përuruar me atë film çmendurak me të. Hej dreq, i gulfoi një klithmë ronitëse nga një shkazmë e thellë diku brenda tij. Ç'më gjeti.

- Ejani.

- Ku?

- Diku. Të pimë diçka.

Ai hodhi një vështrim përçark. Trotuaret dhe rrugët gëlonin nga grupe fëmijësh, kalimtarë, djem të rinj të shushatur, me veshët të shtupuar me kufje kasetofoni portativ të vënë në brez, nga të ftuar në festival me emblemat në kraharor. Vetëtimthi pyeti veten se ku mund të ndodhej Triumfi atë çast. Figuranti i dikurshëm. Që qe diplomuar

për regjisor. Pse nuk qe bërë aktor, të paktën? Me atë paraqitje që krijonte në ekran do të rivalizonte edhe me aktorë të Hollivudit. Po sikur ai ta shihte në veturë të ulur pranë një vajze të huaj?

- Nuk do t'i ndiqni të gjithë filmat?

Ajo bëri një shkundje të këndshme të kokës dhe me një gjest naziq, por të hijshëm, e ftoi sërish të hipte. Atij iu mblodh një komb në grykë - fytyra e saj ishte hipnotizuese. Si mund të jetë pa të dashur një femër e tillë?, pyeti veten. Kush tha që është? Mos e kanë problem këto të kenë partnerë alternativë? Si e dashura e Belmondos te *Frymëmbajturi* që shkonte njëherësh dhe me të tjerë.

I ra makinës përçark dhe hipi në sediljen pranë saj. Me t'u ulur u pendua - më mirë të qe ulur në sediljen e pasme ku do të ishte më i mbrojtur nga vështrimet e njerëzve. Por iu duk zhburrërore t'ia shprehte asaj këtë mendim dhe heshti. Ajo lëvizi dorezën e marshit, nisi makinën e pas pak dolën në një rrugë anësore e prej aty në një rrugë që ngjitej përpjetë kodrës.

Nëse ka në jetë diçka që quhet aventurë, kjo që po bëj tani është e padyshimtë, mendoi ai. Vetëm thikat apo krismat mungojnë.

Rruga gjarpëronte pjerrinës së mbushur me ullinj, ku rrezet ende flakëritëse të diellit përpiqeshin të depërtonin duke sajuar aty-këtu figura surrealistike. Në të majtë shtriheshin vreshta të pafundme si vargjet e një poeme rustike të lexueshme vetëm nga zogjtë. Pas një copë rruge dolën buzë një lajthishte me gjethnajë të dendur.

- Mos po shkojmë në një bar-restorant përtej kodrës?

- Te cili? Se janë disa.

- Nuk më kujtohet emri. Ndodhet pranë një kopshti me pjeshkë. Atje na kanë caktuar të hamë.

- Dhe sikur të shkonim atje, çfarë?

Ai ngurroi për një çast.

- Nuk do të doja të ndeshja një person.

- Nuk është në shfaqje tani ai?

- Nuk i dihet. - Ai buzëqeshi. - Siç nuk jam unë.

- Ah! Qenka i ri?

- Nuk është e thënë të jesh i ri për të lënë një shfaqje.

Ai pa se ajo buzëqeshi çiltër me atë korolar të natyrshëm. Dhe u habit. Buzëqeshja e saj, si të rrezatonte energjinë e duhur për të shkrië një ehull të akullt brenda tij, i krijoi një humor tjetër. Madje i dha zemër dhe ajo iu duk vajzë e mirë. S'mund të jetë ndryshe me atë buzëqeshje të çiltër dhe me atë sjellje të thjeshtë pa kurrfarë

ekzibicionizmi. Kurrigjë e ligë s'mund të fshihet tek ajo. Ajo është e kulluar. Në shpirt e në trup. Të cilin ia ledhatova në dritëhijet e kinemasë teksa shfaqej filmi im i tradhtuar. Prej meje e prej saj. Unë prisja që ajo, si gazetare që është, të shihte filmin tim, kurse ajo u zhyt në një erotizëm të marrë që e ndezi vetë.

- Kush është ai?

- Kryetari.

- Aha.

Ai nuk mund t'i thoshte se nuk i frikej vetëm kryetarit, por edhe pjesëtarëve të një dërgate tjetër. Kishte dëgjuar se në çdo grup që dërgohej jashtë shtetit, njëri ishte spiun. Po sikur të mos të kishte ardhur Triumfi, po vetëm unë e Nasi, cili do të ishte spiuni? Kjo pyetje iu duk e neveritshme, sepse jo vetëm veten e vet, por as Nasin nuk mund ta përfytyronte dot si spiun. Ku i dihet, mendoi, edhe unë mund të isha. Shteti ynë mund t'i fabrikojë spiunët edhe brenda natës.

Ajo i merrte kthesat me shkathtësi. Ai ende nuk e besonte plotësisht njëmendësinë ku ndodhej dhe i bëhej sikur ishte kopja e vetes së tij me origjinalin të mbetur diku. Nuk e kuptonte ç'donte me atë femër të huaj, për më tepër një yll që i qe shfaqur aq papritur në rrugën e jetës së tij. Mos kishte ndonjë keqkuptim në këtë mes? Reshtej t'i kthente sytë nga ajo, ndonëse një forcë e ngjashme me forcën heliotropike që kthen lulen nga drita e detyronte ta bënte. Kjo i ngjet një filmi të sendërgjuar nga një dorë më enigmatike nga ç'është në gjendje të përfytyrojë mendja ime prej trapi, mendoi.

Në altorelievin e kodrës u duk një ndërtesë e bukur, me oborr të gjerë, me një mori dyer-dritaresh që llamburitnin nga reflekset e kuqërremta diellore, me gjelbërim të harlisur e me një shatërvan me currila të ylbhtë. Nëpër kopsht ngriheshin shatorre të mbytura nga bimë kacavjerrëse.

Ajo parkoi makinën, mori çantën e zbriti. E kapi Xhevahirin nga dora si adoleshente dhe me fytyrë të çlirët, me një vështrim ngazëllyeshmërisht të përhumur, u drejtua nga hyrja. Kanatet e xhamta u hapën vetë. Salla e restorantit ishte e bukur dhe e ndritshme.

Ajo vazhdonte t'ia mbante dorën shtrënguar dhe pasi kaluan anash sallës dhe hynë në një korridor të vogël ajo ndaloi, u ngjesh pas parzmit të tij, zgjati fytyrën dhe e puthi. Ai u drithërua nga buhitja e saj, u rrëkëllye në greminën e saj të erëndshme dhe i këndellur nga një ngjethërimë flakëritëse e pa në sy, e pushtoi nga supet, e shtrëngoi fort dhe ia ktheu puthjen me një ashkëti që s'e kishte ndier kurrë.

Pranë tyre kaluan dy kameriere me uniformë dhe ai bëri të shkëputej, por ajo s'deshi t'ia dinte.

- O Zot, - belbëzoi. - Si të rigjeta?!

Ai gapërroi sytë dhe formoi një pyetje të thukët në buzë, por ajo vuri gishtat mbi to. Ç'erënim kishin ata gishta të hollë, me thonj të llakuar në ngjyrë llullaqi. Gjithsesi ajo pyetje do të rikumbonte gjatë në humbellën e trurit të tij.

Ajo e tërhoqi nga dora. Përtej korridorit hapej një sallë tjetër farfuritëse, por atij iu duk se qe pikërisht hyrja e saj ajo që e bëri sallën të ndriste më fort. Gjithandej kishte lule në vazo të mëdha. Atij nuk i kishin zënë sytë lokal më të bukur.

Vetëm dy tryeza qenë të zëna. Ata u ulën pranë dritares. Përtej qelqeve hapej një lugajë laragane ku dukeshin ara e lëndina, një përrua gjarpërues që ndrinte si argjend, vila me tjegulla të kuqe, një tym i kalterremë fjolla-fjolla si ndjesi të çartura. Ngjitur me dritaren ishte një pjeshkë gjethedundur. Ai përfytyroi prillin, kur pjeshka lulëzonte ndërsa një çift në po atë tryezë kundronte lulet e saj.

Pranë tyre qëndroi një kameriere e re. Ajo pa nga ai.

- Ç'dëshironi?

Ai ngriti supet. Edhe pse i ftuar, si kavalier i takonte atij të qeraste. Por kishte pak lireta dhe gjithçka e ndritshme përqark iu terratis. Kishte kartëmodhenën 100-dollarëshe, po si ishin çmimet aty? Kishte dëgjuar se jashtë kishte klube ku një shishe shampanjë mund të kushtonte edhe 50 dollarë. Punë dreqi.

Ajo e kuptoi ngurrimin e tij. I tha kamerieres të vinte pak më vonë dhe duke vënë dorën mbi dorën e tij i foli me një familjaritet aq të natyrshëm, sa ai u përtëri.

- Mund të ma thoni prapë si shqiptohet emri juaj?

- Xhevahir.

- Xheva-hir?

- Po.

-Xheva-hir, - përsëriti ajo. - Unë flas mirë anglisht, po tek emri juaj diçka më pengon. Mund ta thjeshtoj?

- Pse jo?

- *Xhevairio*, bën? Apo e shëmtoj.

- Aspak. Mund të më thërrisni edhe Xhevo. Shumë veta ashtu më thërrasin.

- Xhevo? Jo. *Xhevairio* është më bukur. Ka ndonjë kuptim?

- Po, më duket. Diçka si diamant.

- Ah!

Fytyra a saj mori një ngjyrë alle të përndeaur. Ajo ia vuri të dyja duart mbi dorë dhe e përkuli trupin derisa koka i arriti thuajse rrafsh me tryezën. Dhe nuk ia ndante sytë. Ai e ndiente rrezatimin e tyre si të buronte nga dy perla të zeza. Dhe trupin ia përshekoi një ngjethërimë - nuk e kuptoi pse në atë pozicion, me kokën rrafsh me tryezën dhe me sytë drejtuar nga ai ajo iu duk aq e dashur dhe e afërt, si ta dashuronte prej vitesh. Sa vjeçe mund të jetë? Te njëzet e pesat? Po a është tamam nga trutë?

Për një çast sundoi heshtja. Ajo hodhi vështrimin nga banaku dhe e pyeti sërish:

- Ç'do të merrni? - Ajo u mendua një grimë, kafshoi pak buzën e shtoi: - Mund t'i thërrasim njëri-tjetrit me ti?

- Pse jo?

Ajo buzëqeshi. Dhe duke e lëvizur kokën sa majtas djathtas, si të merrte pozicionin më të mirë për ta fotografuar, gjithnjë duke i mbajtur të dyja duart mbi dorën e tij, i tha:

- Shumë mirë.

Kjo të kujton një kotele, mendoi ai. Një kotele të allasojtë. Që nuk mund të rrih pa e ledhatuar çdo sekondë. Pastaj u mbush me frymë. Iu desh të burrërohej si kurrë ndonjëherë.

- Lori, unë ju falënderoj... - Heshti një grimë e vazhdoi: - Të falënderoj për ftesën, por besoj se kudo është zakon që të paktën në njohjen e parë djali qeras. - Ai u skuq teksa fliste. - Kurse unë...

- Nuk ke para? - Sytë e saj u mbushën me një çiltërsi që e çarmatosën.

- Jo aq sa do të doja t'ju... të të kënaqja.

Këto fjalë i pasoi me një mimikë të buzëve ku spikaste një ndjenjë e theksuar sikleti.

- Xhevairio, në të gjitha ditët e festivalit do të jesh mysafiri im. Do të rrimë bashkë sa herë të mundemi dhe do të shëtitim sa herë të mundemi. Ka problem?

Atij iu përhi fytyra e Triumf Gjokës. Sidomos sytë. Bajagi filmikë edhe tani, që po u afrohej të gjashtëdhjetave. Por tejet të rrezikshëm. Jo bash ata, po diçka përtej tyre, diçka në kafkën e tij të mbushur me skema e kurthe. Ajo e kapi shqetësimin e tij.

- Nuk ju lejohet të shoqëroheni me vajza të huaja?

- Jo se s'na lejohet. Por nuk e shohin me sy të mirë. Përgjithësisht neve nuk na lejohet të shoqërohemi me të huaj.

- Domethënë është me rrezik?
- Sinqerisht, nuk e di. Po ma merr mendja se po.
- Ç'rrezik?

- As këtë nuk e di. Ndoshta na japin vërejtje, na ndalojnë të dalim përsëri jashtë shtetit, na heqin nga puna.

Në fytyrën e saj habia sa vinte e shtohet duke i përfshirë jo vetëm vështrimin e syve, por edhe buzët që iu hapën e mbetën të hapura, si dy petla zambaku uji, që edhe ashtu ishin mrekullisht të bukura.

- Unë nuk di që vendet e tjera të Lindjes t'i trajtojnë kështu të rinjtë e tyre.

- Është më ndryshe në to. Dikur edhe djemtë tanë mund të dashuronin dhe të martoheshin me vajza të vendeve mike - ruse, hungareze, bullgare, polake.... Edhe vajzat tona me djemtë e tyre. Por pasi u prishëm me to, dashuria u ndalua. Edhe me të huaj të tjerë. Kam dëgjuar se një studentja jonë në Kinë dashuronte një student të huaj, kilian më duket. Ambasada jonë i bëri një trysni psikologjike të tmerrshme sa ajo u çmend, e kthyen në atdhe dhe e mbyllën në çmendingë.

Ajo e shikonte me sy të çapëlyer, pastaj vendin e habitë e zuri keqardhja e pastaj frika.

- Atëherë... do të ruhemi. Apo nuk do të takohemi më?

Kur tha këto fjalë iu drodh zëri. Xhevahirin e këputi një krusmë pikëllimi dhe një kujë ia zgavroi gjoksin si erë e shkalluar, erë urrejtjeje për gjithçka çnjerëzore, që nga krimet makabre të Stalinit, të Mao Ce Dunit dhe të Pol Potit e deri tek ato në vendin e tij, ku përfshihej edhe izolimi i llahtarshëm nga bota dhe fobia ngjethëruese për gjithçka të bukur e njerëzore përtej kufijve. Ai deshi të fliste gjatë, por u përmbajt. Ndoshta dhe aq kishte folur shumë. Ndaj vendosi t'i binte drejt se ç'hall kishte tamam në shoqërimin e tij me të.

- S'e kam dhe aq te frika. Puna është se kuotën ditore e kemi të vogël, 2000 lireta dita.

Ajo u habit.

- 2000 lireta?!

- Po. Por qëndrimin dhe ushqimin na i heq festivali.

- E kuptoj. - Ajo vuri buzën në gaz. - Drekat dhe darkat e festivalit herë do t'i hamë, herë jo. Për shpenzimet e shëtitjeve me mua s'ke pse mendon fare, mirë?

Ai vuri buzën në gaz.

- Ndonjë kafe edhe mund t'jua jap.

Edhe ajo buzëqeshi e ia ktheu:

- S'e besoj, se unë pi kafe *lungo*, jo *corto*.

Ajo i shtrëngoi dorën përsëri me të dyja duart dhe ai nuk ia ndante sytë dy unazave të shtrenjta në gishtat e saj të gjatë e delikatë.

- Atëherë, le të porositim. Pastë, dopio xhin e kafe. Mirë?

- Mirë.

Ajo i bëri shenjë me dorë kamerieres, e cila erdhi menjëherë, mori porosinë dhe iku. Ajo përkuli kokën drejt tij, ia kapi fytyrën me të dyja duart dhe e puthi. E puthi gjatë, duke kërkuar me gjuhë gjuhën e tij. Megjithëse në Romë e kudo ku kishte qenë deri në atë kohë ai kishte parë të rinj që putheshin në mes të rrugës, u ndje në siklet. Dhe gati i tha se në vendin e tij, po të shiheshin të rinjtë duke u puthur në mes të rrugës, do ta gdhinin natën në polici, do t'i pushonin nga puna ose do t'i përjashtonin nga shkolla.

- Çfarë shenje je?

Ai nuk e kuptoi.

- Ç'shenjë e horoskopit je.

Ai u hutua. Për horoskopin kishte dëgjuar, por nuk kishte idenë se ç'ishte tamam.

- Kur je lindur?

- Më 23 qershor.

Ajo u mendua pak.

- Gaforrja. Unë, Shigjetari. Nganjëherë e dëgjoj horoskopin në televizor. Edhe fort s'e besoj, por e dëgjoj.

Ai buzëqeshi.

- Te ne s'lejohen gjëra të tilla.

- Po ç'lejohet te ju?

- Të ëndërrojmë fshehurazi ato që lejohen te ju.

Ai pa se si u mug fytyra e saj. Duhet të jetë shumë e ndjeshme, mendoi. Ajo di plot gjëra për vendet e Lindjes, ndoshta më shumë nga ç'mund të mendoj unë, por këto që po dëgjon nga goja ime me siguri e trondisin. Nuk ka si shpjegohet ajo empati në rrudhjen e ballit, në terratisjen e syve, në mbledhjen e buzëve. Ja, m'i hodhi duart prapë. Po afron fytyrën tek unë. I shoh vetëm buzët. Buzët. Që i ka aq të bukura dhe të lyera lehtë. M'i ngjiti. Ma kapi kokën me të dyja duart dhe po më thith. Po thithemi. Ç'është kjo kjo orgazëm buzësh? Ç'i kam këto ndjesi? Apo i kam provuar me Fabiolën dhe i kam harruar? Flinin tek unë dhe i zgjoi kjo apo m'i dhuroi kjo në një mënyrë që nuk ka zot që e merr vesh?



Duke surbur xhinin ai e harroi tronditjen e sikletit që ishte pa një grosh. Kryqëzonte shikimet me të dhe mendonte se si gjithçka që rrokullisur si një ortek që e kishte marrë me vete. Tmerrohej se ndoshta kishte hyrë në një rrugë pa kthim. Ajo vajzë kishte një fuqi çuditërisht tërheqëse. Mos ishte kjo dashuria? Ç'dinte ai për dashurinë? Përvojën me Fabiola Hasimin?

Ajo hapi çantën, nxori një aparat fotografik, rregulloi objektivin dhe diafragmën dhe i bëri disa foto. Pastaj thirri kamerieren, e udhëzoi si ta përdorte aparatën, ul pranë tij dhe kamerierja u bëri disa poza.

Në lokal hyri një grua e re shumë e bukur, e veshur thjesht e hijshëm. Xhevahiri ia nguli sytë dhe mbeti fytyrështangur. Ishte Ornela Muti, e shoqëruar nga një burrë dhe një grua e moshuar. U ulën në një tryezë në qoshe të sallës. Dy kamerierë nxituan t'i shërbenin. Ai pa se edhe Lori po e ndiqte me sy.

- Ç'aktore, - tha ai.

- Dhe si njeri është e mrekullueshme.

- Që në filmin *Gruaja më e Bukur* më ka lënë pa mend. Ç'lojë. Dhe të mendosh se ishte vetëm pesëmbëdhjetë vjeçe. Një yll i vërtetë.

- Edhe tani është yll.

- Po. Por mund të të them diçka?

- Sigurisht.

- Ti je më e bukur.

Ajo nuk foli menjëherë. E pa në sy - ai ishte serioz. Nga shprehja e fytyrës ajo kuptoi se ai e kishte me gjithë mend. Ajo u skuq, i dha një shkundje të hijshme kokës në shenjë modestie të çiltër dhe buzëqeshi.

- Tani e teprave. Dhe nuk besoj të jesh mitoman. Për më tepër që më shkurajove për diçka që dhe unë doja të të thosha.

- Çfarë?

- Ah! Po më shkurajove. Padashur, sigurisht.

- Mund të ma thuash një herë tjetër?

- Nuk e di. - Ajo buzëqeshi dhe i ledhatoi dorën. - Do të ikim apo do të porositim diçka tjetër?

- Nëse nuk ke kundërshtim, ikim.

Ajo thirri kamerieren dhe pagoi duke i lënë një bakshish të mirë. Ndërsa ecnin përmes sallës ai pa se Ornela e mbante kokën nga ajo dhe kur ata kaluan përbri tryezës së saj, ajo u ngrit në këmbë. Lori i tha Xhevahirit ta priste një minutë dhe u takua me Ornelën, të cilën e puthi. Biseduan për një copë herë në këmbë, u puthën prapë e u ndanë.

- Njihemi që në Romë, - i tha ajo kur u kthye. - Dikur edhe unë shkoja në *Cinecitta*.

- Për të luajtur në film?

- Po.

- Ke luajtur?

- Fillova, - tha ajo dhe buzëqeshi. - Por fati nuk deshi të vazhdoja.

Ai e pa me shumë interesim dhe ajo e kuptoi se ai donte të dëgjonte më shumë.

- Është histori më vete. Do të kemi kohë të bisedojmë.

Ajo ndezi makinën, rrotulloi timonin dhe dolën nga oborri. Makina rrëshqiste teposhtë kodrave të stërpikura me reflekse shkëlqimesh; përpara hapej qielli ngjyrë vjollcë i perëndimit me disa re buzargjendta që laheshin në dritë dhe i gjithë peizazhi përmbitej nga një farfuritje fshehtarake dhe gjithçka kishte një pamje të përrallshme.

## 6

Ajo e ndali makinën buzë trotuarit në *Via Aldo Moro*, në afërsi të *Sala Truffaut*, u zgjat drej tij dhe ai e puthi. Ishte një puthje e ngjethërimtë dhe brydhtësia e supeve të saj dhe erëmimi që blironte prej saj e kalamendi si në klub dhe ai nuk shkëputej dot prej saj dhe i vinte t'i thoshte, Pse duhet të ndahemi?, dhe mezi u shkëput dhe u mbush me frymë.

Zbriti pa ia shqitur sytë, i bindur se ajo ishte më e mahnitshme se Ornella Muti te *Romanzo Popolare* dhe mbylli derën dhe prapë e vështroi dhe ajo rrinte me duart në timon, me fytyrën të ndriçuar nga dritëza e sipërme, dhe ai u çudit se përse edhe në gjysmëdritë ajo ishte po aq e bukur në tjetërsimin e saj nator dhe, o Zot, pse duhej të ndaheshin qoftë edhe për pak, pse duhej t'i shqimej drita e syve pa të dhe si do t'ia bënte ai me mungesën e saj që do t'i shpellonte përbrenda ndërkohë që donte të mbante lëkurën e saj të njomësht ngjitur pas lëkurës së tij dhe të mos ndahej nga ai kurm e nga ato forma sepse ndarja do ta shkallmonte. Por duhej.

Ajo i tundi dorën dhe nisi makinën. Ai qëndroi në vend si i shastisur. Gjithçka kishte qenë e bukur përtej ëndrrës...

Teksa ecte trotuarit me çapa të ngadaltë iu kujtua se në vitin e parafundit të Artit Dramatik, pas shfaqjes së dramës *Mulliri i Kostë Bardhit* të kursit të tij, ishte njohur me Fabiola Hasimin, studente në

vitin e parë të inxhinierisë elektrike. Ishte e bukur, e kishte dashur, kishte kaluar edhe në ekstazë me të, por shpejt kishte nisur të vinte re se ajo ishte një ekzibicioniste e çakërditur, e pamposhtur në ambiciet e saj, një boheme e tallazitur që fluturonte në fantazi dhe nuk pushonte së gërvalluri që nuk ia kishin dhënë të drejtën e studimit për atë që kishte kërkuar, filozofi, po për degën elektrike.

Qe e pangopur në gjithçka përveç të ngrënit, që gati e urrente. Nuk ngopej me asgjë fluide - me verë, birra, konjak a ç'të ishte dhe me asgjë argëtuese - filma, muzikë, të puthura, seks. Në seks kishte qenë një egërshane e llahtarshme. Dhe përherë në pozicionin që donte ajo. Dhe përherë me seanca orale.

Megjithë tërheqjen ndaj saj, ai kish nisur të dyshonte nëse marrëdhëniet e tyre ishin vërtet dashuri dhe gati pas një viti që kur qenë njohur i kishte thënë se nuk mund të vazhdonin më. Vendimin e kishte marrë kur ajo qe kapluar nga një krizë xhelozie për Rovena Begën, një shoqen e tij të kursit, duke shpërthyer në një potere të rrëmetshme e duke i dhënë ultimatum që ai të mos i fliste më asaj. Ai qe bindur përfundimisht se nuk mund ta përballonte më tipin e saj trillan e nënshtrues. Mund të qenë ndarë më shpejt, por s'e kishte patur të lehtë ta asgjësonte atë tërheqjen e saj seksuale gjëmëtare. Më parë qenë grindur e pajtuar disa herë, por këtë herë ndarja kishte ardhur vërtet.

Deri vonë kujtimi i saj i qëndronte si një copë akulli e pashkrishme që i therte. Buqeta që kishte përbërë të tërën e marrëdhënieve të tyre intime, ndonëse e shkartisur me gjemba, gjithsesi kishte qenë e bukur dhe çdo kujtim, një kapje dore a një puthje, i vrujonte vrushkullshëm në shpirt e megjithatë ai nuk hoqi dorë nga bindja se dashuria nuk është vetëm puthje e seks, por një mozaik mirëkuptimi, përgjërimi e respekti, një rendje e ethshme duarkapur në një verbëri të ndriçuar dhe kurrë nënshtrim. Dashuria është ndjenjë sipërane dhe nëse nuk merr parasysh ndërsjellshmërinë bëhet sipërane absolute që shkatërron vetveten. Dashurinë më së shumti e kërcënon nënshtrimi dhe jo përherë gozhdën e fundit në arkemort ia vë tradhtia.

Kurse kjo vajzë e huaj në këtë botë të huaj, që i qe bërë papritur aq e afërt, mund ta braktiste, po jo ta nënshtronte. Që një dashuri të lindë rrufeshëm, kjo dihet, por guri i provës është respekti. Mund të dashurosh dikë pa e vënë fare në kandar respektin (ekziston kjo lloj dashurie patologjike...), por ajo nuk vazhdon gjatë. Dhurata e dashurisë na është dhënë si një pasqyrë ku te tjetri ne shohim veten tonë sipas

dritës që ai hedh në të, mendoi.

Ndërsa ecte drejt pjacës së Merkatos i bënte sytë katër se mos e pikaste Triumfi. U gëzua kur në hyrje të kompleksit *ARENA CITTADELLA* pa Nasin në mes të pjesëtarëve të ekipit të Televizionit Shqiptar. Sapo kishin dalë nga një shfaqje filmi.

- Ku humbe? - e pyeti ai që larg.

Të gjithë ia ngulën sytë. Po ky trap pse vë tellallin? Nuk mund të më pyeste mënjane?

- Andej nga kuvendi i Shën Françeskut. Ishte një peizazh i bukur.

Dhe i bëri Nasit shenjë me sy. Ai e kuptoi, e tërhoqi nga mënga dhe i tha:

- Të kërkoi Triumfi.

Ai ndjeu një si nishk të akullt.

- Ç'më donte?

- Nuk ma tha.

- Ti ç'i the?

- Këtu ka qenë, në kinema, duke parë filmat e pasdites. Ke ardhur në kohë, se do të nisemi për në restorant.

Në autobus Nasi ngulmoi ta dinte se ku kishte qenë. Ai ia tregoi dhe Nasi u habit.

- Mos more! Si kështu?

Dritat e restorantit feksnin që larg duke krijuar një fontanë njollash shumëngjyrëshe që lëpinin gjethnajën e errët në konturin e kodrave që vizatohej i ëndërrt në atë qiell të mugët fillimgushti.

Ishte një lokal me oborr të gjerë, me fenerë që spërkatnin me dritë pemët dhe trumbat e luleve që siluetohehin në përgjumje. Natën e gjithë pamja dukej e shkalaveshur nga dritëhijet dhe të ngjallte një ndjesi misteri.

Lokali llamburiste nga refleksjet e qelqërimës së banakut dhe shkëlqimet e takëmeve në tryeza. Ata hanin në një sallë të vogël anësore. Ushqimi shërbehej me tallona, me përjashtim të pijeve alkoolike, që duhej t'i paguaje. Mirëpo sonte, meqë ishte nata e hapjes së festivalit, do të kishte koktej dhe mund të pije falas sa të doje.

Xhevahiri kapërdihej me zor. Nasi e vuri re ndryshimin e tij dhe e pyeti:

- Do ma tregosh?

Xhevahiri e pa buzagaz.

- Do t'i bësh portretin?

- Po të më duket interesante, pse jo?

- Sa për atë është e denjë edhe për penelin e Da Vinçit.

- Ou! Qenka si Mona Liza?

- Mona Liza? Ku është e bukur Mona Liza?

Mbaruan së ngrëni dhe kaluan në sallën e madhe ku kishte filluar kokteji. Mjedisi vibronte nga ecejaket dhe bisedat e të ftuarve ndër të cilët disa ishin kolosë të kinemasë. Mes tyre lundronte edhe Triumfi që kapardisej në delirin e vet klandestin. Madhështia dhe lavdia dilnin nga legjendat dhe mishëroheshin në trajta njerëzore përmes vështrimesh, buzëqeshjesh, shakash, përshpërimash, takimesh e ndarjesh. Burra të moshave të ndryshme, disa me gota në duar, të veshur me kostume luksoze të errëta dhe gra të moshave të ndryshme, të veshura me elegancë, me fustane zharseje, belluzi ose lykre të zeza, të mavijta, të trëndafilta, me vizëllime gjerdanësh, byzylykësh e bizhush e me kundërmime erzinash ndër këmbenin biseda përmes frushullimash e vështrimesh e megjithëse të gjithë kishin dalë nga ekranet për t'u tokësorizuar përsëri, për Xhevahirin dhe Nasin që s'kishin parë botë me sy, pamja e tyre dukej e përrallshme.

Në një tryezë Xhevahiri pa Lorin të ulur me Xhina Lolobrixhidën, Barbara De Rosin e disa të tjerë. Ai i buzëqeshi Lorit dhe ia nguli vështrimin aktorese së famshme që e njihnte nga ekrani qysh në fëmëni dhe i erdhi keq që gjithë ajo bukuri kishte nisur të vdarej. Kurse De Rosi ishte në kulmin e madhësisë.

Në tryezën ngjitur, mes një kompanie të madhe, ishte një mjekrosh fytyrëgjërë që seç thoshte me gjallëri. Midis tyre Xhevahiri dalloi Robert De Niron.

- Serxho Leone dhe Robert De Niro, - pëshpërti Xhevahiri dhe mbajti këmbët. De Niroja nuk kishte ndryshuar fare nga ç'e mbante mend në filmin *Shoferi i Taksisë*. Ç'film i mrekullueshëm!

Mes një grupi burrash e grash ishte Mikele Plaçido. Përsëri mbajtën këmbët për ta vështruar më mirë atë aktor të shquar që me *Oktapodin* qe kthyer në legjendë.

Në një tryezë ishte regjisorja e moshuar amerikane që i qeshi fytyra kur pa Xhevahirin. Ai hodhi sytë rrotull dhe meqë Triumfi nuk ndodhej aty pari, i dha dorën asaj dhe vajzës shoqëruese dhe këmbëu disa fjalë me to.

- Mos lini pa parë filmin tim! - i tha ajo. - Shfaqet pasnesër.

- Patjetër, zonjë.

Rreth orës 9:30 autobusi mbërriti në *Valle Piana*. Deri në kinemanë verore *Maison Lumiere*, ku do të bëhej ceremonia e hapjes

së festivalit, nuk ishte larg dhe Xhevahiri me Nasin, të dy me këmisha e pantallona doku kinez, që i kishin qepur apostafat për vajtjen në festival, ecnin drejt hyrjes me ftesat në duar.

Në hyrje të kinemasë panë Triumfin me një burrë të panjohur trupvogël e korrozi, që e kishte shoqëruar edhe në koktej. Triumfi i njohu, u tha se ishte biri i një emigranti ekonomik, mik i vendit tonë, i cili, nga shprehja e fytyrës, dukej i lumtur që shoqëronte një personalitet të kinematografisë shqiptare.

- Pas ceremonisë do të jepet një film klasik. Mos u largoni, - u tha Triumfi.

Kinemaja ishte shumë e bukur dhe merrte mbi 2000 shikues. Dy diga të fuqishme e bënë dritë skenën gjigante dhe në sfond dëgjohej muzikë. Burra e gra lëviznin në krye të radhëve të gjata të karrigeve të bardha derisa uleshin dhe i gjithë mjedisi ishte plot aroma e pëshpërtje e buzëqeshje e vështrime e thirrje të lehta e shenja dhe yjet e gushtit, të zbehur nga dritat e fuqishme, sikur pulisnin sytë të habitur. Xhevahiri e harroi Triumfin dhe iu bënë sytë ujë për Atë.

Më në fund e pa. Flokët e krehur hijshëm ia nxirrnin më në pah bukurinë. Kishte veshur një fustan të mëndafshtë me trëndafilatë të kuq nën të cilin i harbonin gjinjtë, një gjerdan perlash, vathë të artë të rrumbullakët e një palë sandale të kuqe me taka. Mirëpo ishte e shoqëruar... Dhe jo nga dikush dosido, por nga një burrë i pashëm mjekrosh e shpatullgjerë, i veshur si kont dhe nga një djalosh thatim.

Xhevahirin e shkallmoi një ndjenjë e hidhët asgjësimi. Ndeshja që bëjnë demat për të zotëruar femrën te burrat sendëzohet në përfytyrim, pazhurmshtëm për veshët, por logorishëm për zemrën, me rrëxosje e plojë gjaku e copëra të shqyera dhimbjesh.

Duhej të ruante dinjitetin. I dha një goditje burrit shpatullgjerë dhe ai ia ktheu me një aperkat në nofull. Pse jo, kur ajo i buzëqeshte? O Zot. Të gjithëve ua darovit atë buzëqeshje?

Po. Ja ku i buzëqeshi një tjetri, dikush e përqafoi. S'është faji isaj, bën shumë ferk, mendoi ai. Për t'u çuditur. A s'ka këtu plot aktore të famshme dhe aktore adoleshente mahnitëse të filmave *Y-GEN* të ardhura nga çdo kënd i botës?

Befas atij iu krijua përshtypja se ajo nuk e njihnte, se nuk qenë kapërthyer e puthur në kinema, se nuk patën shkuar te kurrfarë bari ndajnatëherë. Gjithçka kishte qenë një shajni e nxitur nga dëshira e tij e ngulmët për t'u dashuruar me të.

Ajo e pa dhe u dritësua dhe i buzëqeshi dhe i bëri nojmë se e pa.

Atij i mjaftoi ai gjest për të rishfaqur në ekranin e mendjes sekuencat kinemaskopike të xhiruara me të me kamerat e syve të tij. Nga bokset buçiti melodia e Bethovenit dhe prezantuesja njoftoi daljen në podium të kryeministrit Xhulio Andreoti, që u shoqërua me duartrokitje. Triumfit i përkthente emigranti dhe Xhevahiri ndihej i qetë. Andreoti u përqendrua te nevoja e brezit të ri për mësimin e gjuhëve të huaja dhe te qëndrimi larg drogës. Një vajzë miturake e pyeti: Po të kishit një shkop magjik, ç'do të bënit së pari me të? Do të godisja mafien dhe drogëshpërndarësit, që përgjigja e atij burri trupvogël e të mençur, që u shoqërua me duartrokitje.

Ceremonia vazhdoi me daljen në skenë të një sërë personalitetesh të kinemasë dhe të një grupi fëmijësh që përshëndetën të pranishmit. Pas një pushimi të shkurtër do të fillonte shfaqja e filmit klasik. Xhevahiri i pëshpëriti Nasit se do të ikte me të dhe e porositi t'i thoshte Triumfit se nuk ndihej mirë.

Në dalje kishte mjaft njerëz dhe ai e pati të vështirë ta shquante. Më në fund e pa, ishte e shoqëruar vetëm nga ai burri i pashëm. Qëndroi në vend derisa ajo ktheu kokën dhe e pa. Ajo iu shkëput shoqëruesit dhe duke vrapuar sa desh u pengua iu afrua e i tha me pëshpërimë: Më prit përpara *Sala Valle*, mirë? Mirë. Nuk ngatërrohesh tani natën? Jo.

Rrugët ishin të pastra e të qeta dhe shumë dritare ende të ndriçuara. Në atë orë të vonë kishte pak kalimtarë, kurse vetura kalonin dendur. Një makinë plehrash grumbullonte thasët e zinj të mbeturinave. Sytë i përfshinin vitrazhe të ndriçuara, silueta pemësh, grafiti e piktura në mure diku të ndriçuara, diku të errëta, kangjella të shformuara nga pushteti i natës. Në një kthesë u hutua, por si eci pak u orientua dhe ja ku u dukën afishet dhe posterat e ndriçuara të festivalit. Shkoi përpara hyrjes së kinemasë *Sala Valle*, tani e heshtur dhe e errët, dhe ndaloi. Dhe të mendosh se përpara 7-8 orëve atje brenda mua më ndodhi një mrekulli, mendoi. *Sala Valle*. Tempulli që na njohu.

Ai qe lindur e rritur në një qytet të ndërtuar pjesërisht në grykë e pjesërisht në faqe mali, me një lumë të qetë me ura të gurta, me lagjen mbi lumë me shtëpi të vjetra guri, ku ende ekzistonin bezistani dhe çarshia (xhamia ishte mbyllur) dhe jeta i kishte rrjedhur si lumi qytetit të tij që nuk dilte kurrë jashtë brigjeve. Hiq fëmijërinë, që kishte magjinë e vet, pjesa tjetër përbëhej nga vitet e ndritshme të gjimnazit, konkurrimi në artin dramatik, vitet studenteske, dashuria e

çartallosur me Fabiola Hasimin, puna si regjisor në teatrin e qytetit, një flirt me një aktore amatore dhe, prej katër vjetësh, puna si as/regjisor në Kinostudio. Ishte njëzet e nëntë vjeç, por nuk kishte arritur asgjë që t'ia vlente të shënohej.

Një veturë me sinjalet e kuqe që puliteshin ritmikisht ngadalësoi shpejtësinë dhe frenoi. Ishte ajo. Ai iu afrua makinës dhe hipi në sediljen pranë saj me zemrën që i rrihte fort. Ajo i kapi kokën me të dyja duart dhe e puthi. Dhe si i vuri duart sërish në timon, lëshoi një psherëtimë, Mezi iu shmanga!

- Kujt?

- Atij me të cilin më pe. Është regjisor australian.

Ajo lëvizi levën e marshit dhe makina nisi të rrëshqiste duke e shtuar shpejtësinë. Lanë pas ndërtesat e qytezës dhe pasi kaluan një urë të vogël përpara tyre u hap një lugajë e stërpikur me drita.

- Vjen nga Australia dy a tri herë në vit. I ka rënë në kokë për mua dhe sot, para se të njiheshim bashkë, kisha vendosur...

Ajo heshti dhe kafshoi buzën - kishte shkuar paksa larg me atë rrëfim. Për herë të parë që kur qenë njohur ai ndjeu një sëmbim absurd xhelozie.

- Mund t'i përmbahesh vendimit. - Ai i hodhi një vështrim shkarazi.

- Me mua... Unë vetëm një javë jam.

Ajo frenoi dhe frenoi aq vrullshëm, sa rrotat kujisën me një kërkëllimë çjerrëse dhe makina rrëshqiti hosh disa metra. Ajo u lëshua mbi timon dhe mbështeti kokën në të. Supet i dridheshin. Ai e pa fytyrështangur.

- Më fal. Të lutem, më fal.

E kishte dogëndisur, por se përse, nuk po e kuptonte dot. Ajo ngriti kokën dhe në mugëtirë ai arriti të shquante disa rrezëllime refleksesh të kuqe në rigat e lotëve që i kishin vrizuar faqeve.

- Ke të drejtë të mendosh ashtu. Po, i ika një tjetri të njohur prej kohe për të ardhur me ty, një i panjohur, edhe pse e di se sa do të rrih. Por s'jam e atillë... Dita e sotme është më e bekuara në jetën time... Dashuria nuk është dendësuar kurrë tek unë si sot... Pritja e një jete të tërë u ngjesh në një ditë... në më pak se një ditë...

Ajo ia kapi kokën sërish me të dyja duart dhe u zgjat drejt tij. Dhe dridhej. I dridheshin qerpikët, buzët, supet. Ai e shihte i hutuar, pa e kuptuar dot plotësisht gjendjen e saj.

- Dhe unë nuk dua të mendoj për ditën e ikjes tënde, sepse... Nuk dua të mendoj për të...



Ajo i hodhi duart në supe dhe e shkundi fort.

- Ty... sikur të zbriti Zoti. Sepse të kam dashur prej kohe. Dhe mos mendo kurrë se do të dua një tjetër si ty.

Ajo u ngashërye dhe iu mbështet mbi sup fytyrëpërmbys. Ai zhgapërreu sytë, kërveshi buzët dhe qëndroi frymëmbajtur. Ç'është kjo që më thotë se më paska dashur prej kohe? Prej sa kohe? Mos vuan nga ndonjë delir? Është normale, apo jo? Ç'them dhe unë. Ç'hyn deliri këtu? Është figurë letrare. E ka fjalën se ka ëndërruar një tip si unë. Më pa dhe i ngjiti me mua. Të gjithë ata që dashurojnë kështu thonë, por unë jam trap.

Ajo ngriti kokën, zgjati fytyrën drejt tij dhe e puthi. Ai ndjeu gjinjtë e saj t'i rëndonin mbi parzëm, erëmimin e saj, njomështinë e brydhët të saj dhe u shkundullua nga ai vrujim femëror që rrënjonte prej saj. Ajo drejtoi trupin, nxori nga kamarja e kruskotit një paketë kartëpicetash, fshiu lotët dhe nisi makinën. Faret nisën të lyenin sërish pemët, shkurret, gjerdhet e pjerrinat me dritat e tyre vraparake.

- Ku do të shkojmë?

Ajo e kishte mbledhur veten.

- Do të ma lësh mua?

Ai i tundi kokën pohueshëm. Ajo buzëqeshi dhe e pa në sy. Ai vuri re se edhe në mugëtirë vështrimi i saj ende i lagësht kishte një forcë tërheqëse të mistershme. Nuk është e çmendur, po me siguri është ndër femrat e rralla që janë në gjendje ta përjetojnë kësisoj dashurinë. Dhe ajo figura që përdori për ngjeshjen e dashurisë së jetës së saj në një ditë nuk flet për çmenduri. Si mund të jetë e çmendur, kur është gazetare? Një e çmendur s'ka pse vjen në festival. Ajo është e dashuruar. Bulëza e dashurisë është e lindur te ne, tjetri është drita që e kthen në lule. Ajo këtë donte të thoshte.

- Në fillim në një disko. Mirë?

- Mirë.

- Ka disko te ju?

- Jo.

- Kot pyeta, se e di që s'ka.

- Në disa vende të Lindjes ka. Në Rusi, Rumani...

- E di. Kam qenë në Rusi.

- Keni qenë?

- Po. Me një shërbim të shkurtër nga gazeta.

- Ju pëlqeu Moska?

- Shumë.

- Unë është hera e parë që dal jashtë shtetit. Kurse ju duhet të keni qenë në shumë vende.

- Po. Më së shumti në Evropë. Sepse ndjek disa festivale për gazetën. Në Angli kam qenë disa herë. E adhuroj Anglinë, e quaj tempullin botëror të muzikës së sotme. U habita kur mësova se Joe Cocker, *Rolling Stones* dhe *Pink Floyd* qenkan anglezë dhe jo amerikanë. Ajo kënga e *Pink Floyd* "Shine on Crazy Diamond" më trondit thellë. E ke dëgjuar?

- Kam dëgjuar këngë prej tyre, por atë nuk e di.

- Është fantastike. - Ajo heshti derisa mblodhi veten e shtoi: - Në Amerikë kam qenë vetëm një herë. - Heshti sërish, këtë herë pak më gjatë. - Filmi juaj... përqendrohet vetëm te puna. Po kohën e lirë si e kalojnë të rinjtë te ju?

- Bëjnë ndonjë mbrëmje vallëzimi, shkojnë në kinema, teatër, sport. Kur del ndonjë film i ri i huaj, vriten për bileta.

- Si vriten?

- Shtyhen sa u grisen rrobat. Disa hipin mbi kokat e tjerëve.

- Uau! Pse nuk rrinë në radhë?

Ajo e pa me vëmendje dhe ai u ndje në siklet. Mos nuk duhej të hynte aq shumë në detaje?

- Ndoshta ngaqë nuk besojnë se do të arrijnë të marrin.

- Kuptohet që femrat s'marrin dot.

- Ua marrin shokët, vëllezërit... - Ai heshti një grimë e shtoi: -

Te ne përgjithësisht mungojnë kushtet për argëtim.

- E kuptoj. Të tilla kufizime prindërit e mi i kanë jetuar në kohën e fashizmit. U kërkohet vetëm punë, përkushtim, atdhedashuri.

Eh, zemër. Regjimi i vendit tim u kërkon njerëzve shumë më tepër. Për bëmat e tij mund të të flisja gjithë natën, por nuk guxoj. Bile çuditëm ku e gjeta guximin që edhe në klub të fola pak si shumë...

Kaluan në periferinë e Salernos. Dritat e makinës herë binin rrufeshëm në pikturat dhe grafititë e mureve duke i kthyer në ekrane filmash eksperimentale në stopkamera, herë zbulonin pjesë fasadash, herë lazdroheshin në rripin e zbërdhlyët të bregdetit e herë vallëzonin arave e ledheve.